

BANKA E SHQIPËRISË

B U L E T I N I
Z Y R T A R

vëllimi 8 numër 1 janar 2006

Data e botimit 10.02.2006

P Ë R M B A J T J A

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.01, datë 25.01.2006 "Për miratimin e deklaratës së politikës monetare të Bankës së Shqipërisë për gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2005" 5
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.02, datë 25.01.2006 "Për miratimin e rregullores "Për ekspozimin e vlerave numizmatike në Bankën e Shqipërisë dhe administrimin e ruajtjen e tyre"" 43
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.03, datë 25.01.2006 "Për dhënien e miratimit paraprak të licencës për të ushtruar veprimtari bankare, bankës së propozuar "Banka e Parë e Investimeve – Shqipëri sh.a."" 48
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.04, datë 25.01.2006 "Për caktimin e kontrollorëve të jashtëm për auditimin e aktivitetit të Bankës së Shqipërisë" 49



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 01, datë 25.01.2006

PËR

MIRATIMIN E DEKLARATËS SË POLITIKËS MONETARE TË BANKËS SË
SHQIPËRISË PËR GJASHTËMUJORIN E DYTË TË VITIT 2005

Në mbështetje të nenit 2 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë "Deklaratën e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë për gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2005", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Politikës Monetare me dërgimin e kësaj deklarate në: Kuvendin e Shqipërisë, Presidencë, Këshillin e Ministrave, Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Ekonomisë.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Evropian dhe Komunikimit me publikimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

KRYETARI

YLLI MEMISHA

ARDIAN FULLANI

DEKLARATA E POLITIKËS MONETARE PËR GJASHTËMUJORIN E DYTË TË VITIT 2005

I. FJALA E GUVERNATORIT

Gjashtëmuji i dytë i vitit 2005 shënoi, në përgjithësi, një periudhë të favorshme për zhvillimin ekonomik të vendit. Ekonomia shqiptare ka vijuar të zgjerohet, siç dëshmohet nga rritja vjetore e vëllimit të shitjeve, nga rritja e numrit të të punësuarve, nga rritja mjaft e shpejtë e kreditimit të ekonomisë dhe nga rritja e të ardhurave fiskale. Për më tepër, rritja ekonomike është zhvilluar në kushtet e kontrollit të inflacionit dhe të deficitit buxhetor brenda vlerave të programuara, duke mos cënuar ekuilibrat dhe raportet kryesore makroekonomike. Gjithashtu, pozicioni i jashtëm i vendit është përmirësuar më tej dhe kursi i këmbimit ka qenë i qëndrueshëm.

Rritja ekonomike gjatë vitit 2005 është favorizuar edhe nga përmirësimi i klimës ekonomike në nivel global. Ekonomia botërore ka vazhduar të rritet me ritme relativisht të shpejta, gjatë gjashtëmuorit të dytë të vitit. Sipas parashikimeve të fundit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, rritja e ekonomisë botërore për vitin 2005 pritet të jetë në nivelin 4.3 për qind, e ndikuar veçanërisht nga rritja ekonomike e ShBA-së, Azisë dhe Japonisë. Gjithashtu, kushtet financiare në nivel botëror kanë qenë pozitive për financimin e aktivitetit ekonomik, megjithë rritjet e normave të interesit nga dy bankat qendrore më të rëndësishme, FED dhe BQE.

Në retrospektivë, gjashtëmuji i dytë i vitit mund të shihet si një periudhë prove për qëndrueshmërinë e rritjes ekonomike dhe të ekuilibrave makroekonomikë. Gjashtëmuji i dytë u hap me një periudhë të gjatë paselektorale, e cila ndikoi në një përqëndrim më të madh të deficitit buxhetor në këtë periudhë dhe në rritjen e paqartësisë në treg. Pjesërisht si rezultat i veprimit të faktorit të mësipërm, sistemi bankar u përball me mungesë likuiditeti, e cila solli tendenca rritëse për *yield*-in e bonove të thesarit, në prani të një volatiliteti të lartë. Më tej, aktiviteti ekonomik u gjend nën efektin e mungesës së energjisë elektrike, e cila ndikoi drejtpërdrejt prodhimin dhe solli vështirësi financiare për bizneset në formën e kostove më të larta. Nga ana tjetër, rritja e çmimit të naftës në tregun botëror forcoi impulset inflacioniste, duke përforcuar efektin negativ të shkaktuar prej situatës së rënduar energjitike.

Situata e zgjatur paszgjedhore dhe zvogëlimi i stimullit fiskal të tremujorit të dytë, kanë ndikuar në ngadalësimin e ritmit të rritjes ekonomike gjatë tremujorit të tretë, ndërkohë që situata e rënduar energjitike, e cila kulmoi në tremujorin e katërt, frenoi më tej aktivitetin ekonomik gjatë kësaj periudhe. Në këto kushte, Banka e Shqipërisë vlerëson se ekonomia është rritur në terma realë edhe gjatë vitit 2005, rritje e cila gjithsesi është pak më e ulët se niveli i parashikuar prej 6 për qind. Duke konfirmuar tendencat e vëna re gjatë viteve të fundit, rritja ekonomike është mbështetur nga dinamizmi i sektorit privat, veçanërisht në sektorin e shërbimeve dhe të ndërtimit. Zhvillimet faktike të gjashtëmuorit dhe

situata aktuale ekonomike tregojnë se impakti i faktorëve të jashtëm në treguesit kryesorë makroekonomikë ka rezultuar i kufizuar dhe kalimtar. Kjo përbën një sinjal inkurajues për konsolidimin e faktorëve të rritjes ekonomike dhe të ekuilibrave makroekonomikë.

Zhvillimet fiskale kanë ecur përgjithësisht brenda linjave të parashikuara gjatë vitit 2005, duke vazhduar tendencat e konsolidimit fiskal. Shpenzimet buxhetore dhe deficitit buxhetor kanë qenë brenda parametrave të programit buxhetor, çka ka kontribuar në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik dhe në kontrollin e presioneve inflacioniste. Sipas të dhënave të Ministrisë së Financave, deri në muajin nëntor, janë mbledhur 97.8 për qind e të ardhurave të planifikuara dhe janë realizuar rreth 93 për qind e shpenzimeve të programuara. Financimi i brendshëm i deficitit buxhetor arriti në nivelin më të ulët të 7 viteve të fundit në raport me prodhimin e brendshëm bruto, duke lehtësuar barrën që ai paraqet për burimet financiare të ekonomisë. Gjithsesi, duke u nisur edhe nga eksperiencia e këtij viti, Banka e Shqipërisë gjykon se ka nevojë për një njëtrajtshmëri më të madhe në shpërndarjen dhe zbatimin në kohë të programit fiskal.

Gjithashtu, nevojat e zhvillimit të vendit kërkojnë një vëmendje më të madhe në drejtim të respektimit të planit të shpenzimeve kapitale, të cilat, ashtu si dhe vitet e shkuara, vazhdojnë të regjistrojnë shkallë të ulët realizimi. Rritja ekonomike ka krijuar premisa për përmirësimin e tregut të punës, i cili, edhe gjatë vitit 2005, ka ndjekur ecurinë pozitive të viteve paraardhëse. Norma e papunësisë shënoi vlerën 14.2 për qind në tremujorin e tretë, duke arritur në nivelin më të ulët të viteve të fundit.

Sektori i jashtëm i ekonomisë është karakterizuar nga një aktivitet intensiv, duke u reflektuar në rritjen e transaksioneve korente dhe kapitale. Vëllimi i përgjithshëm i eksporteve dhe i importeve, gjatë periudhës korrik-shtator 2005, ishte rreth 650 milionë euro ose rreth 12 për qind më i lartë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm. Megjithëse deficitit tregtar shënoi një rritje vjetore prej 16 për qind në tremujorin e tretë, duke arritur në vlerën 382 milionë usd, flukset hyrëse të kapitalit e kanë mbuluar tërësisht atë, duke mundësuar edhe rritjen e rezervave valutore. Bilanci i pagesave u mbyll me një suficit prej 33.7 milionë eurosh gjatë tremujorit të tretë të vitit 2005, duke bërë që niveli i rezervës valutore të mbulojë 4.6 muaj importe mallrash dhe shërbimesh.

Norma e rritjes vjetore të çmimeve të konsumit është luhatur në gjysmën e poshtme të objektivit të Bankës së Shqipërisë gjatë gjashtëmujorit të dytë, duke zbritur në kufirin e poshtëm të objektivit të Bankës së Shqipërisë në muajin dhjetor. Ndonëse ekonomia ka qenë nën ndikimin e disa goditjeve të ofertës, si çmimet e larta të naftës dhe kriza energjitike, politika monetare dhe fiskale kanë mundësuar krijimin e një mjedisi makroekonomik të favorshëm për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Banka e Shqipërisë nuk ka konstatuar lindjen e efekteve dytësore apo rritjen e pritjeve inflacioniste në ekonomi. Harmonizimi i mirë i politikave makroekonomike dhe pozitat e forta të lekut kanë amortizuar presionet inflacioniste.

Në prani të zhvillimeve normale inflacioniste, Banka e Shqipërisë ka ndjekur një politikë monetare neutrale, duke e lënë të pandryshuar normën bazë të interesit në nivelin 5 për qind. Në këto kushte, politika monetare dhe kuadri operacional i saj janë fokusuar në zbutjen e luhatjeve të treguesve monetarë dhe të normave të interesit të bonove të thesarit. Sistemi bankar ndjeu mungesën e likuiditetit gjatë periudhës korrik-tetor, si pasojë e uljes së papritur të interesit të depozitave në lekë nga disa banka dhe e rritjes së kërkesës së ekonomisë dhe të qeverisë për mjete monetare gjatë tremujorit të tretë. Kjo mungesë likuiditeti u përcoll më tej në rritjen e shpejtë të *yield*-it të bonove të thesarit. Këto zhvillime kërkuan një administrim të kujdesshëm të situatës monetare, duke balancuar kërkesat për injektim likuiditeti me nevojën për kontrollin e presioneve inflacioniste në ekonomi. Vëllimi mesatar i injektuar nëpërmjet instrumentit të repove të anasjellta, gjatë periudhës korrik-shtator, ishte 1.7 miliardë lekë. Po kështu, Banka e Shqipërisë ka kredituar për periudha të caktuara kohore qeverinë, duke zbutur presionet e tepërta në rritjen e *yield*-it të bonove të thesarit. Kjo politikë rezultoi e suksesshme. Në fund të gjashtëmujorit, *yield*-i i bonove të thesarit është rikthyer në nivele të përafërta me ato të muajit qershor, ndërsa sistemi bankar është me tepriçë likuiditeti. Banka e Shqipërisë ka blerë valutë gjatë pothuaj gjithë gjashtëmujorit të dytë, duke zbutur presionet mbiçmuese mbi kursin e këmbimit dhe duke injektuar likuiditet në treg. Këto ndërhyrje kanë injektuar rreth 12.4 miliardë lekë likuiditet, duke ndihmuar sistemin bankar në tejkalimin e situatës dhe duke lehtësuar ekspansionin joinflacionist të ofertës monetare.

Viti 2005 është shoqëruar nga një rritje e shpejtë e ofertës monetare. Ritmi i rritjes së ofertës monetare shënoi vlerën 14.3 për qind, në muajin nëntor. Kreditimi i ekonomisë ka qenë burimi kryesor i përdorimit të fondeve dhe i ekspansionit monetar, duke spostuar për herë të parë financimin e deficitit buxhetor nga ky rol. Në fund të muajit nëntor, kredia për ekonominë arriti në 114.6 miliardë lekë, e barabartë kjo me 13.7 për qind të PBB-së. Vetëm gjatë periudhës korrik-nëntor kredia është rritur me 2.5 pikë përqindjeje ndaj PBB-së, ndërkohë që ritmet e rritjes vjetore të kredisë janë luhatur rreth nivelit 70 për qind. Kredia ka shënuar rritje në të gjithë sektorët e ekonomisë, duke reflektuar një lidhje më të ngushtë të bizneseve dhe konsumatorëve me bankat. Banka e Shqipërisë vlerëson se kushtet monetare aktuale dhe tendenca e pritur e tyre janë konsistente me ruajtjen e stabilitetit të çmimeve në periudhën afatmesme.

Viti që lamë pas, tregoi se ekonomia e vendit tonë ka krijuar një lloj imuniteti, një pikë rezistence, e cila krijon premisa të mira për zhvillime më cilësore në të ardhmen. Megjithatë, konsolidimi i mëtejshëm i saj është një proces në vazhdim, ku ndër të tjera, përparësi mbetet kryerja me ritme më të shpejta e reformave të shumta të parashikuara në programin afatmesëm trevjeçar të zhvillimit të vendit.

Banka e Shqipërisë, duke vlerësuar rolin e saj si një nga institucionet kyçe në përmbushjen me sukses të objektivave ambiciozë të këtij programi afatmesëm, ka hartuar tashmë programin monetar për vitin 2006. Duke u mbështetur në supozimet bazë të këtij programi për një rritje ekonomike 5 për qind në kushtet e një inflacioni mesatar 3 për

qind, Banka e Shqipërisë parashikon që rritja e ofertës do të jetë në nivelin 11.8 për qind. Kjo rritje vlerësohet të jetë e mjaftueshme për të përmbushur nevojat e ekonomisë për mjete monetare dhe veçanërisht, për të mundësuar një zgjerim të kredisë në kufirin e 53 miliardë lekëve ose rreth 45 për qind të totalit. Duke vazhduar logjikën pozitive ekonomike të vitit 2005, financimi i deficitit buxhetor nga sistemi bankar parashikohet të konsumojë rreth 12.8 miliardë lekë ose ¼ e fondeve të parashikuara për kreditim. Banka e Shqipërisë vlerëson se mbështetja në rritje e biznesit shqiptar me fonde të brendshme përbën një premisë pozitive për ruajtjen e ritmeve të larta të rritjes ekonomike edhe në të ardhmen.

II. EKONOMIA BOTËRORE

Ekonomia botërore ka vazhduar të rritet me ritme relativisht të shpejta edhe gjatë gjashtëmuajorit të dytë të vitit. Impulsi kryesor në aktivitetin ekonomik botëror ka ardhur veçanërisht nga rritja ekonomike e ShBA-së, Azisë dhe Japonisë. Sipas parashikimeve të fundit¹ të Fondit Monetar Ndërkombëtar, rritja e ekonomisë botërore për vitin 2005 pritet të jetë në nivelin 4.3 për qind. Situata në tregjet financiare botërore paraqitet pozitive për financimin e aktivitetit ekonomik, në sajë të çmimeve të larta të aktiveve financiare, kostos së ulët të huamarrjes dhe fitimeve pozitive të korporatave. Nga ana tjetër, ekziston një rrezik për rritjen ekonomike, i pranishëm ky jo vetëm në çmimet e larta të naftës por dhe në zhbalancimet fiskale në vendet më të zhvilluara, në rritjen e deficitit të bilancit të pagesave në një sërë vendesh si dhe në diferencat që ekzistojnë në zhvillimin e ekonomik midis rajoneve.

	PBB-T3	Norma e papunësisë	IÇK
USA	+4.1	4.9 (nëntor)	+3.5 (nëntor)
Eurozonë	+1.6	8.3 (tetor)	+2.3 (nëntor)
Gjermani	+1.4	11.5 (nëntor)	+2.3 (nëntor)
Francë	+1.8	9.7 (tetor)	+1.6 (nëntor)
Itali	+0.1	7.7 (qershor)	+2.2 (nëntor)
Britani	+1.7	4.9 (tetor)	+2.1 (nëntor)
Japoni	+2.9	4.5 (tetor)	-0.7 (tetor)

Tabelë 1. Disa tregues kryesorë ekonomikë (ndryshime vjetore në përqindje).

Burimi: Departamenti Amerikan i Punës, Departamenti Amerikan i Tregtisë, Revista "The economist", 24 dhjetor 2005 - 6 janar 2006.

Ekonomia e Eurozonës

Prodhimi i brendshëm bruto në Eurozonë shënoi një rritje më të shpejtë në tremujorin e tretë. Sipas të dhënave paraprake, rritja ekonomike gjatë këtij tremujori ishte 0.6 për qind, kundrejt një rritjeje prej 0.3 për qind dhe 0.4 për qind në tremujorët e parë dhe të dytë të këtij viti. Rritja ekonomike erdhi kryesisht si rezultat i rritjes së investimeve, të eksporteve, të shpenzimeve individuale për konsum dhe të importeve. Informacioni mbi besimin e biznesit tregon për një qëndrueshmëri të pritur të rritjes ekonomike për pjesën e mbetur të vitit. Rritja e vazhdueshme në kërkesën globale pritet të ndihmojë eksportet e Eurozonës, ndërsa

investimet pritet të përfitojnë nga kushtet e favorshme financiare dhe rritja e ndjeshme e fitimeve të korporatave. Nga ana tjetër, parashikimi për aktivitetin ekonomik mbetet subjekt i rreziqeve që lidhen kryesisht me çmimin e lartë të naftës, shqetësimeve mbi mungesën e ekuilibrave globalë dhe besimit të dobët të konsumatorëve. Norma vjetore e inflacionit për muajin nëntor në Eurozonë ishte 2.3 për qind nga 2.6 dhe 2.5 për qind në dy muajt e mëparshëm. Norma e inflacionit pritet të jetë më e lartë se sa norma e synuar prej më pak se 2 për qind edhe për një periudhë afatshkurtër. Identifikimi i disa presioneve në rritje mbi stabilitetin e çmimeve bëri që në muajin dhjetor, Banka Qendrore Evropiane të rrisë normën bazë të interesit me 0.25 pikë përqindjeje. Ky ndryshim pritet të jetë i mjaftueshëm për ruajtjen e pritshmërive afatmesme dhe afatgjata të inflacionit në linjë me objektivin e stabilitetit të çmimeve.


Ekonomia Amerikane

Aktiviteti ekonomik i Shteteve të Bashkuara të Amerikës shënoi një rritje të shpejtë gjatë tremujorit të tretë të këtij viti. Sipas të dhënave më të fundit, rritja vjetore e PBB-së për tremujorin e tretë shënoi 4.1 për qind, nga 3.3 për qind që ishte në tremujorin e dytë. Shpenzimet konsumatore, investimet fikse të rezidentëve dhe të jorezidentëve dhe shpenzimet qeveritare, janë kontribuesit kryesorë në rritjen e ekonomisë amerikane. Parashikimet për zhvillimin ekonomik në terma afatshkurtër mbeten të mira. Presionet inflacioniste, të shkaktuara pjesërisht nga efektet negative të uraganeve pritet të zbuten, duke ndikuar kështu pozitivisht në pritshmëritë për inflacionin dhe vazhdueshmërinë e rritjes me ritme të shpejta të produktivitetit. Në këto kushte, Rezerva Federale Amerikane (FED) pritet të moderojë agresivitetin për rritjen e normave të interesit.

Çmimi i naftës

Çmimi i naftës ka patur një rënie gjatë muajve të fundit. Megjithatë, ai shfaq një rritje të dukshme në terma vjetorë.

Grafik 1. Çmimet e naftës së papërpunuar (në dollarë amerikanë për fuçi).



Burimi: Statistikat zyrtare të energjisë të Qeverisë Amerikane.

Luhatshmëria e çmimit të naftës gjatë muajve të fundit ka ardhur kryesisht nga diferencat midis kapaciteteve rafinuese dhe kërkesës. Sipas të dhënave më të fundit për nëntë muajt e parë të vitit dhe parashikimeve të OPEC-ut për tre muajt e fundit të vitit 2005, kërkesa botërore për naftë pritet të rritet me 1.2 milionë fuçi në ditë, duke arritur në një mesatare ditore prej 83.3 milionë fuçi në ditë. Oferta e vendeve jashtë OPEC-ut pritet të arrijë një mesatare prej 54 milionë fuçi në ditë ndërsa prodhimi mesatar për vendet e OPEC-ut vlerësohet të ketë arritur një mesatare prej 30 milionë fuçi në ditë, në muajin tetor.

	2004	T1 2005	T2 2005	T3 2005	T4 2005
a-Kërkesa botërore për naftë	82.09	83.65	82.09	82.42	84.93
b-Oferta pa përfshirë vendet e OPEC-ut.	53.94	54.55	54.77	54.09	54.61
c- Oferta nga OPEC.	29.06	29.48	29.92	30.21	
Balanca (b+c-a)	0.91	0.38	2.61	1.87	30.32


Tabelë 2. Oferta dhe kërkesa botërore për naftë (në milionë fuçi në ditë).

Burimi: Organizata e Vendeve Eksportuese të Naftës (OPEC).

Kursi i këmbimit.

Monedha e Eurozonës ka shfaqur tendenca nënçmuese ndaj dollarit amerikan gjatë muajve të fundit. Kursi i këmbimit të euros është nënçmuar me 2.44 për qind gjatë kësaj periudhe. Kursi i këmbimit të dollarit amerikan është ndikuar pozitivisht nga normat relativisht të larta të interesit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Rritja e normës bazë të interesit nga Banka Qendrore Evropiane (ECB) në muajin dhjetor, ka ndikuar në stabilizimin e kursit të këmbimit gjatë këtij muaji. Në fund të muajit dhjetor, një euro këmbehej me 1.179 usd duke u mbiçmuar me 0.24 për qind në krahasim me një muaj më parë.

Grafik 2. Ecuria e kursit të këmbimit usd/euro.



Burimi: Banka Qendrore Evropiane.


III. EKONOMIA SHQIPTARE GJATË GJASHTËMUJORIT TË DYTË

Aktiviteti ekonomik në vend ka patur shenja të dukshme rritjeje gjatë vitit 2005. Ky konstatim mbështetet në disa tregues, si rritja e vëllimit të shitjeve, rritja e numrit të të punësuarve, rritja e shpejtë e kreditimit të ekonomisë dhe rritja e të ardhurave fiskale. Kështu, shitjet e ekonomisë gjatë nëntë muajve të parë të vitit kanë qenë 16.2 për qind më të larta se e njëjta periudhë e vitit 2004. Indeksi i shitjeve totale ka shënuar një rritje vjetore prej 14.7 për qind gjatë tremujorit të tretë. Megjithatë, situata e rënduar energjitike e tremujorit të katërt ka patur një ndikim negativ në aktivitetin e biznesit shqiptar.

Mbështetur në të dhënat më të fundit monetare, kreditimi i ekonomisë ka njohur një rritje të fortë gjatë vitit 2005. Teprica e kredisë u rrit me 18.7 miliardë lekë gjatë periudhës korrik-nëntor, duke shënuar një rritje prej 19.5 për qind të tepricës së kredisë. Për herë të parë duket se raporti i kredisë për ekonominë me kredinë për qeverinë është përmbysur në favor të së parës, duke dhënë një sinjal pozitiv se edhe në të ardhmen sistemi bankar do të vazhdojë të gjenerojë burime financiare për rritjen dhe gjallërimin e ekonomisë.


Sipas të dhënave nga sektori i jashtëm i ekonomisë të hyrat valutore nga emigracioni gjatë vitit 2005 duket se kanë ruajtur tendencat e viteve të fundit duke përbërë një tjetër faktor të rëndësishëm në sigurimin e ritmeve të qëndrueshme të rritjes ekonomike.

Grafik 3. Ndryshimi vjetor i shitjeve sipas tremujorëve (në përqindje).




Burimi: INSTAT, Indeksi i shitjeve, tremujori III 2005.

Grafik 4. Ecuria e shitjeve të ekonomisë gjatë periudhës T1 '01 – T3 '05.



Burimi: INSTAT, Indeksi i shitjeve, T3 2005.

Grafik 5. Kontributi i sektorëve në shitjet e ekonomisë (në pikë përqindje).



Burimi: INSTAT, Indeksi i shitjeve, T3 2005.

Duke u bazuar në këtë tablo, Banka e Shqipërisë vlerëson se ekonomia do të ketë rritje edhe gjatë vitit 2005, por ajo do të jetë diçka më e ulët se niveli i parashikuar prej 6 për qind.

Tremujori i tretë i vitit ka shënuar një rritje të shpejtë të sektorëve të shërbimeve dhe të ndërtimit. Shitjet e sektorit të shërbimeve ("Tregti, hotele, restorante") kanë patur një rritje vjetore prej 15.1 për qind gjatë tremujorit të tretë të vitit, duke dhënë kontributin më të madh në zgjerimin e aktivitetit ekonomik gjatë kësaj periudhe. Ky kontribut vlerësohet të jetë 7 pikë përqindjeje, duke përbërë pothuajse gjysmën e rritjes vjetore të ekonomisë. Zgjerimi i aktivitetit në këtë sektor ka sjellë edhe rritjen në 47 për qind të peshës së tij në ekonomi, nga 43 për qind që ishte në tremujorin e dytë të vitit. Rritja e peshës së sektorit të shërbimeve është shoqëruar me zvogëlimin e peshës së sektorit të industrisë. Ndërkohë, peshat e sektorëve të tjerë të ekonomisë nuk kanë patur ndryshime të ndjeshme gjatë kësaj periudhe.

Sektori i tregtisë, i hoteleve dhe i restoranteve

Pas një rritjeje të konsiderueshme në tremujorin e dytë të vitit 2005, zhvillimet e sektorit "Tregti, hotele dhe restorante" kanë qenë pozitive edhe gjatë tremujorit të tretë. Shitjet e këtij sektori kanë shënuar një rritje vjetore prej 15 për qind ndërsa në krahasim me tremujorin paraardhës, shitjet paraqiten 15.8 për qind më të larta. Ashtu si dhe në disa sektorë të tjerë, ritmet e rritjes së shitjeve në këtë sektor janë zvogëluar gjatë tremujorit të tretë.

Sektori i bujqësisë

Prodhimi i sektorit të bujqësisë pritet të rritet me 3.9 për qind gjatë vitit 2005, i mbështetur nga rritja me 2.5 për qind e prodhimit bujqësor dhe rritja me 10 për qind e sektorëve të agroindustrisë dhe të peshkimit. Këto pritje janë më pesimiste krahasuar me parashikimin e fillimvitit dhe realizimin e tij në vitin 2004. Të punësuarit në sektorin e agroindustrisë janë rritur me 1 për qind në krahasim me një vit më parë.

Emërtimi	Realizimi '04	Parashikimi '05
Bujqësia	3.2	2.5
Agroindustria	10.2	10
Peshkimi	7.9	10
Total	4.7	3.9

Tabelë 3. Parashikimi i prodhimit bujqësor sipas degëve, në përqindje.

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit.

Ritmi i rritjes së prodhimit bujqësor është zvogëluar me 0.7 pikë përqindje gjatë periudhës janar – shtator 2005 në krahasim me rritjen e një viti më parë, duke manifestuar një lloj zhvillimi spontan dhe varësi të konsiderueshme nga kushtet e motit. Ende gjatë vitit 2005 problemet e shumta ligjore me tokën nuk morën zgjidhje, duke vazhduar të pengojnë në këtë mënyrë një rritje sasiore dhe cilësore të prodhimit bujqësor.

Sipas vrojtimit të agroindustrial, prodhimi agroindustrial është rritur me 4 për qind gjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2005, ndërkohë që përpunimi i prodhimeve bujqësore ka rënë me 11 për qind gjatë tremujorit të tretë të këtij viti. Ulja e kapaciteteve përpunuese ka ndikuar drejtpërdrejt në uljen me 44 për qind të eksporteve të degës së agroindustrial, duke ndikuar edhe eksportin total të sektorit të bujqësisë. Eksportet bujqësore në total, gjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2005, janë zvogëluar me 21.2 për qind, ndërkohë që duhet theksuar se edhe importet nga ana tjetër kanë regjistruar rënie me 11.5 për qind.

Në blegtori situata e eksport/importeve është e përmbysur, eksportet janë ulur me 12 për qind gjatë nëntëmujorit, krahasuar me një vit më parë dhe importet janë rritur me 10.4 për qind.

Sektori i industrisë dhe energjisë

Rritja vjetore e shitjeve të sektorit të industrisë arriti në 10 për qind gjatë tremujorit të tretë të vitit, duke shënuar gjithsesi një ngadalësim në krahasim me rritjen 23.6 për qind të shënuar në tremujorin e dytë. Megjithatë, sektori i industrisë vazhdon të zërë vendin e dytë në shitjet e ekonomisë gjithsej edhe gjatë gjashtëmujorit të dytë 2005.


	Pesha ndaj totalit	T3 '05/T3 '04	9-mujor '05/9-mujor '04
Industria gjithsej	100	11.87	10.06
Industria nxjerrëse	8	16.05	14.3
Industria përpunuese	67	10.04	7.5
Energjia elektrike, ujë, gaz	25	15.3	16.0

Burimi: INSTAT, Indeksi i shitjeve, T3 2005.

Tabelë 4. Ecuria e sektorit të industrisë për tremujorin e tretë 2005 (në përqindje).

Shitjet në vlerë absolute të degës "Energji elektrike, ujë dhe gaz" shënuan një rritje vjetore prej 16 për qind gjatë tremujorit të tretë të

Grafik 6. Ndryshimi tremujoror i shitjeve në sektorin "Tregti, hotele, restorante" (në përqindje).



Burimi: INSTAT, Indeksi i shitjeve, T3 2005

vitit. Gjatë periudhës korrik – nëntor 2005 u shënuar një rritje prej 7 për qind në burimet energjitike, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Prodhimi i brendshëm u rrit me 3.8 për qind në këtë periudhë, duke plotësuar 76.3 për qind të kërkesës së brendshme përdoruese. Gjatë tremujorit të fundit, Shqipëria u përfshi në një krizë energjitike, e cila erdhi si pasojë e nivelit të ulët të prodhimit dhe të importit. Gjatë muajve tetor dhe nëntor importet u rritën në mënyrë të konsiderueshme në krahasim me muajt korrik-shtator, për të përballuar kërkesën vendase për energji. Konsumi familjar, i cili përbën 57 për qind të përdorimit të konsumit të energjisë, u ul me 5.1 për qind gjatë këtyre muajve në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tabelë 5. Treguesit kryesorë të bilancit të energjisë elektrike (në GWh).


	Korrik -05	Gusht -05	Shtator -05	Tetor -05	Nëntor -05	Kor-Nën 05 /Kor-Nën 04	11m 05 /11m 04
Burimet gjithsej	495.6	474.6	471.7	507.8	449.3	7.0%	6.7%
Prodhim	406.7	395.6	380.7	362.0	286.2	3.8%	4.0%
Import (përfshirë këmbimet)	88.9	79.0	91.0	145.8	163.1	18.7%	23.7%
Eksport (përfshirë këmbimet)	43.9	25.3	54.7	47.6	30.7	294.0%	126.3%
Humbjet në rrjet	145.0	149.8	116.4	165.0	162.4	8.9%	1.0%
Furnizimi për konsumatorët	306.6	299.4	300.5	295.2	256.3	-3.1%	-0.8%
Përdorim familjar	167.6	176.6	171.7	166.4	153.4	-5.1%	-4.1%
Përdorim jofamiljar	139.0	122.8	128.8	128.8	102.9	-0.4%	3.9%

Burimi: Korporata Elektroenergjitike Shqiptare.

Ndërtimi

Shitjet në sektorin e ndërtimit shënuan një rritje të ndjeshme prej 19.7 për qind në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të 2004. Gjatë nëntëmujorit të parë të vitit, shitjet në këtë sektor janë rritur me 25.5 për qind. Shpenzimet direkte në ndërtim u ulën me 0.31 për qind në krahasim me tremujorin e kaluar dhe 0.37 për qind në krahasim me tremujorin e tretë të vitit 2004. Shpenzimet materiale gjithashtu patën një rënie të lehtë me 0.36 për qind në krahasim me tremujorin e kaluar, ndërsa përkundrajt të njëjtës periudhë të një viti më parë nuk u shënuar pothuajse asnjë ndryshim. Fitimi i parashikuar pati një rënie prej 2.78 përqindësh ndaj tremujorit të tretë të vitit të kaluar.

Grafik 7. Ritmet vjetore të rritjes së shitjeve në ndërtim (në përqindje).



Burimi: INSTAT.

Transporti

Shitjet në sektorin e "Transportit dhe Telekomunikacionit" u rritën me 10.3 për qind në tremujorin e tretë të këtij viti, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Transporti detar i mallrave pati një rritje prej rreth 16.6 për qind gjatë muajve korrik – nëntor të këtij viti në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kështu importet u rritën me 7.7 për qind ndërsa

eksportet u ulën me 28.8 për qind, në portet kryesore të vendit. Transporti hekurudhor në Shqipëri përbën vetëm 1 për qind të trafikut të mallrave dhe atij të pasagjerëve. Gjatë muajve korrik - nëntor të vitit 2005, transporti hekurudhor i mallrave pati një rënie prej 29 për qind. Ndërsa transporti hekurudhor i pasagjerëve u ul në masën 15 për qind. Transporti ajror ka patur një rritje mesatare vjetore prej rreth 15 për qind në 10 vitet e fundit. Kështu, ky trend ka vazhduar gjatë 9 muajve të parë të vitit 2005, ku u vu re një rritje në nivelin 24 për qind të numrit të fluturimeve dhe 22 për qind të numrit të pasagjerëve. Investimet në këtë sektor kanë patur një rënie prej rreth 28.8 për qind gjatë tremujorit të tretë të këtij viti në krahasim me të njëjtin periudhë të një viti më parë. Kjo rënie ka ardhur si pasojë e nivelit të ulët të investimeve të brendshme dhe të huaja, të cilat kanë qenë respektivisht 21.6 dhe 43.9 për qind më pak se tremujori i tretë i vitit të kaluar.


III.1 TREGU I PUNËS

Gjatë vitit 2005, tregu i punës vazhdoi të ruajë ecurinë e mirë që manifestoi në fundin e vitit 2004, ku treguesit e punës shfaqën një tendencë të fortë rritjeje. Krahasuar me tremujorin e tretë të një viti më parë, numri i të punësuarve është rritur me 9200 vetë, ku vetëm të punësuarit në sektorin privat jobuqësor janë rritur me 3 mijë vetë. Ndërkohë, struktura e tregut të punës nuk pati ndryshime gjatë vitit 2005. Kështu, sektori shtetëror vazhdon të zërë rreth 19 për qind të numrit total, sektori privat jobuqësor zë 23 për qind dhe ai privat bujqësor 58 për qind të të gjithë forcave të punës².

	Viti		2005						
	2002	2003	Tr.I	Tr.II	Tr.III	Tr.IV	Tr.I	Tr.II	Tr.III
Forcat e punës gjithsej	1167	1093	1080	1081	1080	1088	1087	1086	1086
A. Të punësuar gjithsej	991	927	919	921	922	931	931	931	931.2
i) në sektorin shtetëror	188	184	179	179	177	176	176	175.6	175.6
ii) në sektorin privat jo bujqësor	160	209	206	208	211	213	213	213.4	214
iii) në sektorin privat bujqësor	644	534	534	534	534	542	542	542	542
B. Papunësia (në mijë)									
i) të papunë gjithsej	175.5	165.8	161	160	158	157	156	155	154.8
ii) përfitojnë pagesë papunësie	12.3	11	11.7	12.3	12	11	11.5	11.5	11.5
C. Shkalla e papunësisë (%)	15.1	15.2	14.9	14.8	14.6	14.4	14.4	14.3	14.2


Burimi: INSTAT, Koniuktura, dhjetor 2005.

Grafik 8. Indeksi i kushtimit në ndërtim.



Burim: INSTAT.

Grafik 9. Investimet në sektorin e transportit në vite* sipas burimeve (në miliardë lekë).




Burimi: Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit
*Të dhënat e vitit 2005 përfshijnë 9 muajt e parë të tij.

Tabelë 6. Treguesit e tregut të punës (në mijë vetë).

Numri i të papunëve është ulur me 3200 vetë gjatë katër tremujorëve të fundit të mbuluar me të dhëna, ndërsa norma e papunësisë është ulur me 0.4 pikë përqindjeje. Në tremujorin e tretë numri i të papunëve ka rënë me 200 vetë, duke e çuar normën e papunësisë në 14.2 për qind. Përmirësimi i treguesve të punësimit duket se është shoqëruar edhe me rritjen e të ardhurave. Të dhënat për pagat në sektorin shtetëror, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2005 tregojnë se paga mesatare në sektorin publik është rritur me gati 9 për qind, në terma vjetorë.

Grafik 10. Numri i të papunëve në tre vitet e fundit (në mijë vetë).



Megjithatë, të dhënat e tregut të punës vazhdojnë të kenë deformime në treguesit, si rezultat i veprimit të fenomeneve të tilla si: migrimi i paregjistruar i popullsisë që ka sjellë ndryshim të vazhdueshëm të raportit të popullsisë rurale dhe asaj urbane, si dhe vazhdimi i ekzistencës së tregut të zi të punës.

III.2 SEKTORI FISKAL

Treguesit fiskalë kanë qenë përgjithësisht afër niveleve të parashikuara gjatë 11 muajve të parë të vitit 2005. Sipas të dhënave të Ministrisë së Financave, deri në muajin nëntor janë mbledhur 97.8 për qind e të ardhurave të planifikuara dhe janë realizuar rreth 93 për qind e shpenzimeve të programuara për këtë periudhë. Kjo ka bërë që deficitin buxhetor, në fund të muajit nëntor, të jetë rreth 16.3 miliardë nga 27 miliardë lekë të parashikuara. Shpenzimet dhe deficitin buxhetor në total, në periudhën janar – nëntor 2005, arritën nivelet më të ulëta në 7 vitet e fundit në raport me Prodhimin e Brendshëm Bruto. Një rënie të dukshme në raport me PBB-në patën shpenzimet kapitale dhe financimi i brendshëm i deficitit.

Tabelë 7. Treguesit kryesorë fiskalë (në përqindje ndaj PBB-së).

	11M 99	11M 00	11M 01	11M 02	11M 03	11M 04	11M 05
Të ardhurat totale	21.7	22.3	19.6	21.1	21.6	21.3	21.1
Të ardhura tatimore	13.5	15.6	13.2	14.7	19.2	19.3	19.0
Shpenzime totale	31.8	29.7	25.4	26.1	25.3	24.5	23.0
Shpenzime korente	26.1	24.1	19.7	21.4	21.7	20.7	19.7
Shpenzime kapitale	5.6	5.5	5.5	4.7	3.6	3.8	3.3
Deficiti	(10.1)	(7.5)	(5.8)	(5.0)	(3.7)	(3.2)	(1.9)
Financimi i brendshëm	4.0	4.5	3.2	2.2	2.8	2.5	1.4
Financimi i huaj	6.0	2.9	2.6	2.9	0.9	0.7	0.5

Burimi: Ministria e Financave.

Të ardhurat dhe shpenzimet janë rritur respektivisht me 9.3 për qind dhe 3.7 për qind në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke shënuar një rritje më të vogël se mesatarja e 7 viteve të fundit. Financimi i brendshëm i deficitit deri në muajin nëntor arriti në 11.9 miliardë lekë, përkundrajt nivelit prej 16.2 miliardë lekësh të parashikuar. Financimi i huaj i deficitit u arrit deri në 40 për qind të vlerës së parashikuar.

	11M 99	11M 00	11M 01	11M 02	11M 03	11M 04	11M 05	Mes. 99-05
Të ardhura totale	15.2	14.3	5.7	15.7	12.8	11.3	9.3	12.0
Të ardhura tatimore	13.9	28.8	1.8	19.7	43.2	13.2	9.0	18.5
Të ardhura nga pushteti lokal	13.9	57.9	39.7	32.0	252.1	13.3	16.0	60.7
Të ardhura nga buxhetet e pavarura	14.7	10.7	3.3	23.1	11.5	12.7	10.6	12.4
Të ardhura jotatimore	19.5	(26.2)	29.5	(9.3)	(6.6)	(10.4)	(6.7)	(1.5)
Shpenzime totale	15.5	4.3	2.7	10.4	6.8	9.1	3.7	7.5
Shpenzime korente	9.7	3.0	(1.9)	17.1	11.5	7.4	5.0	7.4
Shpenzime kapitale	49.9	9.1	21.1	(8.6)	(15.1)	19.9	(3.7)	10.4
Deficiti	16.3	(17.4)	(6.0)	(7.1)	(18.6)	(3.3)	(34.2)	(10.1)
Financimi i brendshëm	(9.3)	24.9	(14.7)	(27.7)	43.5	1.3	(39.1)	(3.0)
Financimi i huaj	43.5	(45.9)	7.5	18.1	(65.3)	(17.8)	(15.6)	(10.8)

Burimi: Ministria e Financave.

Tabelë 8. Ritmet e rritjes vjetore të treguesve kryesorë fiskalë (në përqindje).

Të ardhurat buxhetore

Të ardhurat buxhetore të nëntëmujorit të parë të vitit kanë patur një rritje vjetore prej rreth 9.3 për qind. Të ardhurat nga tatimet janë burimi kryesor i të ardhurave buxhetore duke përbërë rreth 90 për qind të të ardhurave totale. Niveli i tyre arriti në 165.1 miliardë lekë në fund të muajit nëntor, duke realizuar me 100.4 për qind nivelin e parashikuar në buxhet.

Kontributin kryesor në realizimin e të ardhurave tatimore e kanë dhënë tatimi mbi fitimin, taksa e qarkullimit të automjeteve, tatimi mbi vlerën e shtuar dhe akcizat, të cilat tejkalojnë planin me 16.5, 41.9, 2.0 dhe 1.7 për qind respektivisht. Tatimet e mbledhura nga doganat rezultuan rreth 12.2 miliardë lekë, duke arritur në 87.8 për qind të nivelit të planifikuar. Ndërsa tregues të tjerë kryesorë të tatimeve si: tatimi mbi të ardhurat personale dhe ato doganore u realizuan me 97.1 dhe 87.8 për qind, respektivisht. Gjithashtu, vihet re se të ardhurat nga pushteti lokal vazhdojnë të tejkalojnë planin duke u realizuar në 110.8 për qind, ndërsa të ardhurat nga buxheti i pavarur dhe ato jotatimore u realizuan në masën 98.5 dhe 85.6 për qind respektivisht.

	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Plani 11M %	Plani vjetor %
Të ardhura totale	109.0	125.2	142.8	161.5	180.8	97.8	87.5
Të ardhura tatimore	99.6	114.4	130.8	147.4	165.2	100.4	90.6
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	33.6	38.9	45.2	51.8	58.4	102.1	92.2
Tatimi mbi fitimin	10.7	12.1	13.7	15.2	17.1	116.5	106.6
Akcizat	9.3	11.1	13.1	15.1	16.9	101.7	92.7
Tatimi mbi të ardhurat personale	3.9	4.4	5.1	5.5	6.4	97.1	84.0
Taksa doganore	7.0	8.2	9.5	10.8	12.2	87.8	78.1
Taksë qarkullimi për automjete	2.3	2.5	2.7	2.8	2.8	141.9	130.8
Të ardhura nga pushteti lokal	6.9	7.8	8.6	9.5	10.6	110.8	102.3
Të ardhura nga buxheti i pavarur	20.3	23.0	25.9	29.2	32.2	98.5	87.8
Të ardhura jotatimore	8.2	9.3	10.5	11.8	12.8	85.6	74.0

Burimi: Ministria e Financave.

Tabelë 9. Treguesit kryesorë (të dhëna progresive - në miliardë lekë).

Shpenzimet buxhetore


Shpenzimet buxhetore arritën në nivelin 197.1 miliardë lekë në fund të muajit nëntor, duke përbërë rreth 93 për qind të nivelit të programuar për këtë periudhë. Niveli i rritjes së shpenzimeve për këtë periudhë ishte afërsisht sa gjysma e mesatares së rritjes në shtatë vitet e fundit. Shpenzimet e personelit, të cilat përbëjnë rreth 28 për qind të shpenzimeve korente, u realizuan në masën 97.9 për qind. Shpenzimet korente (për periudhën janar – nëntor 2005) përbëjnë rreth 85 për qind të shpenzimeve totale. Ristrukturimi i administratës publike pritet të japë efekte më të theksuara në vitin 2006, me shpenzime më të pakta sidomos në treguesin e shpenzimeve për personelin. Ndërkohë, shpenzimet kapitale vazhdojnë të realizohen më pak se niveli i planifikuar. Kështu, për 11 muajt e parë të vitit ato u realizuan në masën 71.9 për qind. Nga këto të fundit, shpenzimet e mbuluara me financim të huaj janë realizuar vetëm në masën 52.5 për qind të planit.

Tabelë 10. Përbërja e shpenzimeve korente (në miliardë lekë – të dhëna progresive).

	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Plani 11M %	Plani vjetor %
Shpenzime totale	123.2	140.7	161.8	179.7	197.1	93	79
Shpenzime korente	107.3	121.7	138.9	153.6	168.5	99	87
Personeli	29.6	33.6	38.1	42.1	46.5	98	84
Interesat	15.9	17.9	20.6	22.3	24.0	88	80
Të brendshme	14.9	16.8	19.4	20.9	22.5	90	82
Të huaja	975.0	1.2	1.2	1.3	1.5	68	60
Shp. operative mirëmbajtjeje	13.5	14.5	16.7	18.6	20.4	108	93
Shp. për sigurime sociale etj	30.9	35.9	40.6	45.0	49.3	98	89
Shpenzime buxheti lokal	9.6	11.0	12.9	14.5	16.3	116	92
Shpenzime të tjera	5.8	6.6	7.4	8.2	9.1	101	89
Shpenzime kapitale	15.9	18.9	22.8	26.1	28.6	72	57
Financim i brendshëm	10.4	12.7	15.4	17.4	19.4	87	69
Financim i jashtëm	5.6	6.3	7.4	8.7	9.3	52	41

Burimi: Ministria e Financave.

Grafik 11. Deficiti mujor buxhetor për vitin 2005 (në miliardë lekë).



Burimi: Ministria e Financave.

Deficiti fiskal

Deficiti fiskal në fund të muajit nëntor ishte afërsisht rreth 60.3 për qind e nivelit të planifikuar. Mbatja e shpenzimeve nën kontroll dhe realizimi i të ardhurave kanë bërë që deficiti buxhetor të regjistrojë rënien më të lartë në shtatë vitet e fundit. Gjatë kësaj periudhe u regjistruan 4 muaj në të cilat buxheti kishte suficit, ndërkohë që në 8 vitet e fundit ka rezultuar se ka patur mesatarisht vetëm një muaj në vit me suficit. Deficiti është përqendruar në tremujorin e tretë, ndërsa tremujori i katërt deri në nëntor rezulton me një suficit prej 2.7 miliardë lekësh.

III.3 SEKTORI I JASHTËM I EKONOMISË

Bilanci i përgjithshëm i pagesave u mbyll me një suficit prej 33.7 milionë eurosh, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2005. Flukset hyrëse të kapitalit

kanë mbuluar tërësisht deficitin korent si dhe kanë mundësuar rritjen e rezervave valutore. Gjatë kësaj periudhe sektori i jashtëm i ekonomisë është karakterizuar nga një aktivitet intensiv, i cili është reflektuar në rritjen e të ardhurave dhe të shpenzimeve korente. Tremujori i tretë ka shënuar një deficit korent rreth 65 për qind më të ulët sesa ai i tremujorit paraardhës, por rreth 2.8 herë më të lartë se deficitin korent i regjistruar në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Vëllimi i përgjithshëm i eksporteve dhe importeve gjatë periudhës korrik –shtator të këtij viti ishte rreth 650 milionë euro ose rreth 12 për qind më të lartë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.

	T-III'04	T-IV'04	T-III'05	T-I&III'05
Llogaria korente	-25.0	-129.0	-67.0	-222.5
Bilanci tregtar	-329.3	-389.4	-382.2	-1022.4
Llogaria kapitale dhe financiare	13.9	339.2	34.5	248.0
Bilanci i përgjithshëm	78.1	45.9	33.7	44.8

Tabelë 11. Zërat kryesorë të bilancit të pagesave sipas tremujorëve (në milionë euro).

Burimi: Banka e Shqipërisë.

III.3.1 Llogaria korente

Llogaria korente gjatë tremujorit të tretë ka regjistruar një vëllim të përgjithshëm të transaksioneve prej rreth 4.5 miliardë eurosh ose 22 për qind më të lartë se ai i të njëjtës periudhë të vitit 2004. Rreth 73 për qind e transaksioneve korente janë përfaqësuar nga transaksionet në mallra dhe shërbime.

Në krahasim me tremujorin e tretë të vitit të kaluar, tremujori në fjalë ka shënuar disa ndryshime jo tepër pozitive si për shembull: thellimi i deficitit tregtar në masën 16 për qind, rritje e theksuar e deficitit të shërbimeve (nga rreth 5 milionë në rreth 45 milionë euro) dhe një rënie e lehtë e suficitit në llogarinë e të ardhurave. Rritja në transfertat korente shtetërore dhe sidomos private, ka balancuar thellimin e deficitit ose zvogëlimin e suficitit në këta zëra. Për pasojë, tremujori është mbyllur me një deficit korent rreth 40 milionë euro më të lartë sesa tremujori i tretë i vitit të kaluar.

Tregtia e jashtme

Gjatë periudhës janar-shtator të këtij viti aktiviteti tregtar në mallra me botën shënoi një vlerë prej 1.8 miliardë eurosh. Shkëmbimi tregtar i mallrave për këtë periudhë ka përfaqësuar rreth 40 për qind të vëllimit të përgjithshëm të transaksioneve korente të kryera gjatë kësaj periudhe. Ekonomia e vendit dhe tregu i brendshëm mbeten të orientuara drejt importeve, të cilat për këtë periudhë kanë qenë rreth 3.85 herë më të larta sesa eksportet.

Për periudhën korrik-shtator vëllimi i tregtisë së jashtme, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, është rritur me 650 milionë euro ose rreth 11.8 për qind. Si të ardhurat nga eksportet, ashtu edhe shpenzimet për importe kanë shënuar rritje të ndjeshme, por rritja e

importeve si në përqindje ashtu edhe në vlerë absolute, ka qenë më e lartë sesa rritja e eksporteve. Për pasojë, deficitin tregtar i mallrave është rritur me 16 për qind ose me 50 milionë euro.

Raporti eksport/import është ulatur në kufijtë 20-25 për qind gjatë gjithë viteve të fundit. Ky raport duhet të tërheqë vëmendjen drejt politikave të zëvendësimit të importeve si edhe drejt nevojës për të diversifikuar dhe mbështetur eksportet, të cilat aktualisht paraqesin një

shkallë të lartë përqëndrimi dhe një varësi të theksuar ndaj një numri të kufizuar shtetesh, që blejnë nga Shqipëria mallra të prodhuar në vend me lëndë të parë të importuar (rieksporte). Transfertat korente, të cilat përfaqësohen në një masë të madhe nga të ardhurat nga emigrantët, nuk mund të konsiderohen si një burim i pashtershëm dhe i përhershëm financimi për deficitin e vazhduar tregtar.

Shërbimet

Gjatë periudhës korrik-shtator, bilanci i shërbimeve shënoi një deficit prej rreth 44.2 milionë eurosh. Ky deficit ishte rreth 2 herë më i thellë sesa deficitin e regjistruar në tremujorin paraardhës dhe rreth 9 herë më i madh sesa deficitin e regjistruar në të njëjtin tremujor vitin e kaluar. Rezidentët kanë shpenzuar rreth 306


milionë euro për të blerë shërbime nga jorezidentët, ndërkohë që këta të fundit kanë shpenzuar rreth 260 milionë euro për të blerë shërbime në territorin shqiptar ose të siguruar nga njësi rezidente në Shqipëri (si për shembull shërbime të telekomunikacionit). Peshën më të madhe të shërbimeve si në të ardhura, ashtu edhe në shpenzime e zënë shërbimet e turizmit (63 për qind të të ardhurave dhe 54 për qind të shpenzimeve) si edhe shërbimet e transportit, të cilat kanë siguruar 12 për qind të të ardhurave dhe 29 për qind të shpenzimeve. Aktualisht, aktiviteti i turizmit vazhdon të përfaqësojë një

nga burimet kryesore të të ardhurave në valutë për ekonominë e vendit tonë dhe, si i tillë, duhet të konsiderohet si një nga motorët e rritjes së ekonomisë shqiptare. Vlen të theksohet se eksporti i shërbimeve gjatë tremujorit të tretë të këtij viti, ka qenë rreth 17.5 për qind më i lartë se eksporti i mallrave.

Të ardhurat


Bilanci i të ardhurave gjatë këtij tremujori ka rezultuar pozitiv. Suficiti prej rreth 44 milionë eurosh ka qenë rreth 2 herë më i lartë se ai i

Grafik 12. Bilanci i tregtisë së jashtme (në milionë euro).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 13. Shërbimet sipas tremujorëve (në milionë euro).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

shënuar në tremujorin e dytë, por rreth 14 për qind më i ulët se suficiti i regjistruar në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Rritja e të ardhurave ka ardhur si pasojë e rritjes së të ardhurave nga puna e punëtorëve sezonalë dhe atyre kufitarë, si dhe nga rritja e interesave të akumuluar nga investimet e rezervave valutore të sistemit bankar, në formën e investimeve të portofolit.

Transfertat

Gjatë tremujorit të tretë të këtij viti, në llogarinë e transfertave korente janë shënuar zhvillime pozitive. Transfertat private kanë qenë rreth 20 për qind më të larta si në krahasim me tremujorin paraardhës, ashtu edhe në krahasim me tremujorin e tretë të vitit të kaluar. Të ardhurat nga emigrantët ose remitancat, vlerësohet të kenë mbuluar rreth 77 për qind të deficitit tregtar. Ato përbëjnë pjesën kryesore (93 për qind) të transfertave korente. Gjatë këtij tremujori, të ardhurat nga emigrantët kanë shënuar nivelin 295 milionë euro, ndërkohë që transfertat shtetërore, edhe pse më të larta se në tremujorët paraardhës, mbeten disa herë më të ulëta sesa ato private.

III.3.2 Llogaria kapitale dhe financiare


Flukset neto në llogarinë kapitale dhe financiare janë vlerësuar rreth 34.5 milionë euro gjatë tremujorit të tretë të vitit 2005. Gati 72 për qind e këtyre hyrjeve, gjatë muajve korrik-shtator, vijnë nga transfertat kapitale. Gjithsesi, llogaria kapitale ka qenë rreth 16 për qind më e ulët në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Llogaria financiare për tremujorin e tretë paraqitet me një fluks kapitalesh neto prej 9.4 milionë eurosh, në ndryshim nga e njëjta periudhë e vitit të kaluar kur kjo llogari shënonte një bilanc negativ.

Investimet e huaja direkte në këtë tremujor ishin rreth 53 milionë euro, duke qenë pothuajse në nivelin e investimeve të tremujorit të dytë, por diçka më të ulëta sesa investimet direkte të kryera në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Detyrimet financiare të Shqipërisë ndaj botës janë rritur me rreth 9 milionë euro.

III.3.3 Mjetet rezervë


Mjetet e rezervës valutore janë rritur me 33.7 milionë euro, duke bërë që niveli i rezervës valutore të arrijë në rreth 1 miliard e 72 milionë

Grafik 14. Të ardhurat sipas tremujorëve (në milionë euro).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 15. Transfertat sipas tremujorëve (në milionë euro)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

euro, një sasi e mjaftueshme për të mbuluar 4.6 muaj importe mallrash dhe shërbimesh.

Tabelë 12. Bilanci i Pagesave sipas tremujorëve.

	T-III'04	T-IV'04	T-I'05	T-II'05	T-III'05
Llogaria korente	-25.0	-129.0	-51.6	-103.9	-67.0
Eksporti i mallrave	121.6	125.0	121.5	143.3	133.7
Importi i mallrave	-450.9	-514.4	-398.0	-507.0	-515.9
Bilanci tregtar	-329.3	-389.4	-276.5	-363.7	-382.2
Shërbimet:Kredi	223.8	201.1	196.5	237.4	262.0
Shërbimet: Debi	-229.0	-230.4	-225.9	-261	-306.2
Shërbimet (neto)	-5.2	-29.3	-29.4	-23.6	-44.2
Të ardhurat: Kredi	55.8	39.3	37.4	39.5	51.2
Të ardhurat: Debi	-5.1	-6.8	-5.1	-9.6	-7.6
Të ardhurat (neto)	50.7	32.5	32.3	29.9	43.6
Transferatat private	244.5	242.3	210.2	243.3	295
Transferatat shtetërore	16.7	18.5	11.8	10.1	20.8
Llogaria kapitale	29.1	28.5	35.5	14.6	25.0
Llogaria financiare	-15.2	110.7	29.0	134.4	9.4
Llogaria kapitale & financiare	13.9	339.2	64.5	149.0	34.5
Investimet direkte	58.7	42.6	45.3	50.3	53
Investimet e portofolit	98.2	-95.9	-42.9	-5.3	40.9
Kapitale të tjera	-172.2	164.0	21.9	89.4	-89.3
Gabimet dhe harresa neto	84.9	35.6	-3.3	-43.7	66.2
Bilanci i përgjithshëm	78.1	45.9	9.7	1.4	33.7
Rezervat dhe zëra të lidhur me to					
Mjetet e rezervës	-78.1	-45	-9.7	-1.4	-33.7
Përdorim huash e kredish nga FMN	4.8	0	4.6	0	4.8

Burimi: Banka e Shqipërisë.

III.4 ECURIA E INFLACIONIT

Inflacioni vjetor është luhatur në gjysmën e poshtme të objektivit të Bankës së Shqipërisë gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit. Pas një rritjeje të butë gjatë pjesës së parë të gjashtëmujorit, inflacioni vjetor ka qenë në rënie, duke arritur vlerën 2 për qind në muajin dhjetor. Gjithashtu, norma mesatare e inflacionit vjetor është luhatur në intervalin e ngushtë 2.1 – 2.4 për qind gjatë periudhës korrik – dhjetor.

Tabelë 13. Norma vjetore e inflacionit (në përqindje).

	2001	2002	2003	2004	2005
Janar	2.2	6.5	0.0	3.3	3.3
Shkurt	1.5	7.6	1.1	4.4	1.8
Mars	2.9	7.5	1.3	4.0	1.6
Prill	3.0	6.5	2.3	3.2	1.3
Maj	2.5	4.6	2.8	2.6	2.0
Qershor	4.0	3.7	2.6	2.9	2.9
Korrik	5.6	4.2	3.0	3.1	1.8
Gusht	4.1	5.5	3.0	2.7	2.3
Shtator	3.5	5.3	2.8	2.0	3.1
Tetor	1.8	5.8	2.9	2.0	3.3
Nëntor	2.8	3.7	3.4	2.2	3.0
Dhjetor	3.5	1.7	3.3	2.2	2.0
Mesatar	3.1	5.2	2.2	3.0	2.4

Burimi: INSTAT


Zhvillimet makroekonomike kanë mundësuar krijimin e një mjedisi makroekonomik të favorshëm për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Harmonizimi i mirë i politikave makroekonomike, mungesa e presioneve inflacioniste nga kahu i ofertës dhe pozitën e forta të lekut, kanë amortizuar presionet inflacioniste.

III.4.1 Ecuria e inflacionit dhe e grupeve përbërëse

Inflacioni vjetor njohu një rritje nga 1.8 për qind në 3.3 për qind gjatë periudhës korrik-tetor, për të shënuar ulje më tej gjatë dy muajve pasues. Grupet kryesore të shportës së konsumit, "Ushqime dhe pije joalkolike", "Qira, ujë, lëndë djegëse, energji", "Transporte" dhe "Hotele, restorante dhe kafe", kanë qenë përcaktuesit kryesorë të ecurisë së inflacionit, duke ruajtur të njëjtën strukturë kontributi.


"Ushqime dhe pije joalkolike". Zhvillimet në çmimet e konsumit kanë treguar se niveli i përgjithshëm i çmimeve gjatë gjashtëmuorit të dytë të vitit 2005, ka ndjekur dinamikën e çmimeve të mallrave ushqimorë. Në ndryshim nga gjysma e parë e vitit, kontributi i këtij grupi në inflacionin vjetor gjatë gjashtëmuorit të dytë ka qenë me kahe të kundërta për muaj të veçantë. Kontributi mesatar i grupit "Ushqime dhe pije joalkolike" në normën vjetore të inflacionit të kësaj periudhe ka qenë zero. Në ndryshim nga vitet e kaluara, inflacioni vjetor i këtij grupi në muajin dhjetor ishte negativ (-1.9 për qind). Mungesa e rritjes së tepruar të kërkesës konsumatore, ka dekurajuar rritjen artificiale të çmimeve gjatë këtyre festave. Inflacioni i këtij grupi uli me -0.8 pikë përqindjeje normën vjetore të inflacionit në muajin dhjetor.

Grafik 16. Inflacioni vjetor (në përqindje).



Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë.

Grafik 17. Kontributi i grupeve kryesore në inflacionin vjetor (në pikë përqindjeje).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

	Inflacioni vjetor'04	Kontributi (pp)	Inflacioni vjetor'05	Kontributi (pp)	Itali ³ Inflacioni vjetor'05	Greqi ⁴ Inflacioni vjetor'05
Korrik	-0.1	-0.05	-1.6	-0.7	-0.2	0.7
Gusht	-1.4	-0.6	0.0	0.0	-0.2	1.3
Shtator	-2.9	-1.2	1.5	0.6	0.1	2.1
Tetor	-2.2	-0.9	1.7	0.7	0.2	2.7
Nëntor	-1.6	-0.7	0.2	0.1	0.6	2.6
Dhjetor	0.3	0.1	-1.9	-0.8	-	-

Burimi: Banka e Shqipërisë; Sekretariati i Përgjithshëm i Shërbimit Statistikor Kombëtar të Greqisë, ISTAT-Italia.

Tabelë 14. Inflacioni vjetor i grupit "Ushqime dhe pije joalkolike" (në vend dhe jashtë) si dhe kontributi i këtij grupi në inflacionin total.

"Qira, ujë, lëndë djegëse, energji". Ndryshimet në çmimet e administruara vazhdojnë të jenë burimi kryesor i presioneve inflacioniste në vend. Rritja

e çmimit të energjisë elektrike, në muajin janar 2005, ndikoi normën e inflacionit përgjatë gjithë vitit. Kontributi mesatar i grupit “Qira, ujë, lëndë djegëse, energji” në inflacionin total të gjashtëmujorit të dytë ishte 2.3 pikë përqindjeje, thuajse në të njëjtat nivele me kontributin e dhënë gjatë gjashtëmujorit të parë. Krahas rritjes së çmimit të administruar të energjisë elektrike, në ecurinë e inflacionit të këtij grupi ka ndikuar dhe rritja e çmimeve të lira të tregut të lëndëve djegëse, të qirasë dhe të rentës së imputuar. Rritja e çmimeve të lëndëve djegëse, të gazit dhe të druve të zjarrit, erdhi si pasojë e krizës energjitike që përfshiu vendin në muajt tetor – nëntor. Rritja e kërkesës për këto alternativa zëvendësuese të energjisë, solli rritjen e çmimeve të tyre që u përkthye në norma më të larta inflacioni (23.1 -23.4 për qind) për nëngrupin “Lëndë djegëse, energji”, në periudhën tetor – dhjetor. Gjithashtu, çmimi i qirasë njohu rritjen më të madhe në muajin dhjetor, ku shënoi një inflacion vjetor prej 4.9 për qind.

Tabelë 15. Norma vjetore e inflacionit dhe kontributi i grupit “Qira, ujë, lëndë djegëse, energji” në inflacionin total.


	Inflacioni vjetor '04	Kontributi (pp)	Inflacioni vjetor '05	Kontributi (pp)
Korrik	9.9	2.4	7.7	2.0
Gusht	9.7	2.4	6.9	1.8
Shtator	10.4	2.5	7.7	2.0
Tetor	9.2	2.2	8.2	2.1
Nëntor	9.2	2.2	9.0	2.3
Dhjetor	8.8	2.1	9.0	2.3

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë.

“Transport”. Në ndryshim nga gjashtëmujori i parë i vitit, çmimi i naftës është kthyer në një kosto domethënëse për konsumatorët shqiptarë. Megjithëse me një peshë të vogël prej 4.8 për qind në shportën përfaqësuese të konsumit, grupi “Transport” ka shënuar norma të larta inflacioni vjetor gjatë periudhës korrik – dhjetor. Ai ka kontribuar mesatarisht me 0.23 pikë përqindjeje në inflacionin vjetor të kësaj periudhe (në krahasim me 0.13 pikë përqindje gjatë periudhës paraardhëse). Norma më e lartë e inflacionit prej 6.1 për qind është regjistruar në muajin shtator. Rritja e çmimit të naftës u akomodua dhe nga nënçmimi i lekut ndaj dollarit amerikan⁵ - faktor ky i cili lehtësoi transmetimin më të plotë të kësaj rritjeje nga tregu ndërkombëtar në tregun vendas. Krahas presioneve të jashtme për rritjen e çmimit të këtij produkti, tregu vendas u përball me një kosto prodhimi më të lartë. Gjatë tremujorit të tretë, çmimi i prodhimit të naftës bruto shënoi një rritje vjetore prej 3.2 për qind. Megjithatë, ekonomia shqiptare nuk duket të jetë prekur nga efektet dytësore të rritjes së çmimit të naftës.

“Hotele, kafene, restorante”. Gjashtëmujori i dytë i vitit 2005 u karakterizua nga rritja e çmimeve në sektorin e shërbimeve. Grupi “Hotele, kafene, restorante” ka dëshmuar për ritme më të larta rritjeje në krahasim me gjashtëmujorin e parë. Ky grup ka dhënë një kontribut mesatar prej 0.2 pikësh përqindjeje në shifrën totale të inflacionit vjetor për këtë periudhë. Rritja më e dukshme është shënuar kryesisht gjatë tre muajve të fundit. Nëngrupi “Shërbime akomodimi” ka shënuar norma vjetore inflacioni nga 28.3 për qind në 28.7 për qind.

Grupet e tjera të shportës kanë respektuar tendencat e shfaqura në pjesën e parë të vitit edhe gjatë gjashtëmujorit të dytë të tij. Grupet “Pije alkoolike dhe duhan” dhe “Mallra dhe shërbime të ndryshme” kanë shënuar norma pozitive rritjeje, ndërsa grupet si “Veshje dhe këpucë” dhe “Mobilim, pajisje dhe mirëmbajtje shtëpie” kanë vazhduar të regjistrojnë norma negative të inflacionit. Në total këto grupe kanë kontribuar mesatarisht në inflacionin vjetor me -0.1 pikë përqindjeje. Ndërsa ndikimi i çmimit të administruar të energjisë dhe një ndikim konstant gjatë vitit, çmimet e tjera të administruara janë rritur në mënyrë të ndjeshme, gjatë gjashtëmujorit të dytë të këtij viti. Grupet “Shëndeti” dhe “Shërbimi arsimor” kanë dhënë një kontribut mesatar përkatësisht me 0.14 dhe 0.1 pikë përqindjeje në inflacionin vjetor të periudhës në analizë.




III.4.2 Ambienti makroekonomik dhe çmimet e konsumit


Kushtet makroekonomike gjatë gjashtëmujorit të dytë kanë qenë përgjithësisht të favorshme për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Pavarësisht krizës energjitike të muajve tetor–nëntor dhe çmimeve të larta të naftës – faktorë të cilët shtuan presionet inflacioniste - ambienti makroekonomik mund të cilësohet i favorshëm. Tregues të rëndësishëm makroekonomikë dëshmojnë për rritje më të ngadaltë të aktivitetit ekonomik në tremujorin e tretë, për situatë të qëndrueshme në tregun e punës dhe për qëndrueshmëri të pozitive të lekut kundrejt valutave të huaja. Gjithashtu, normat e ulta të inflacionit janë mbështetur nga koordinimi i mirë i politikës fiskale me atë monetare, në kushtet e një ambienti të jashtëm tregtar me ndikim të dobët inflacionist.

Faktorët e kërkesës

Politika fiskale dhe treguesit fiskalë. Politika fiskale ka ecur me hapa të matur, duke treguar kujdes në zbatimin e buxhetit të miratuar. Treguesit fiskalë kanë respektuar nivelet e parashikuara. Kështu, shpenzimet buxhetore dhe deficitit buxhetor janë në nivele më të ulta se ato të parashikuara për njëmbëdhjetë muajt e parë të vitit. Gjithashtu, shpenzimet buxhetore janë rritur me ritme më të ulta gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2005, në krahasim me gjashtëmujorin e parë dhe me vitin e kaluar. Zbatimi i matur i politikës fiskale, pavarësisht rritjes së shpenzimeve buxhetore dhe rritjes modeste të pagave në sektorin shtetëror, ka mundësuar kushte për kontrollimin e normës së inflacionit.



Grafik 20. Ndryshimet vjetore të ofertës monetare dhe të parasë jashtë bankave ndaj M3.



Politika monetare dhe treguesit monetarë. Në mungesë të presioneve inflacioniste, politika monetare ka akomoduar zhvillimet makroekonomike, duke ndjekur një politikë monetare neutrale. Gjatë gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2005, oferta e parasë shënoi ritme më të ngadalta rritjeje, por duke plotësuar kërkesën e lartë të ekonomisë për kredi. Nga ana tjetër, raporti i parasë jashtë bankave ndaj ofertës së parasë, si dhe normat afatgjata të interesit kanë arritur në rënie, duke reflektuar uljen e pritshmërive për inflacionin dhe duke sjellë arritjen e qëndrueshmërisë në kohë të tij, pa kosto të mirëfillta për ekonominë.

Kërkesa e brendshme. Tremujori i tretë i vitit 2005 shënoi një rritje më të ngadaltë të aktivitetit ekonomik në krahasim me tremujorin paraardhës. Indeksi i shitjeve shënoi një rritje


vjetore prej 14.7 për qind dhe rritje tremujore prej 4.9 për qind ndaj tremujorit paraardhës. Këto norma në tremujorin e dytë ishin përkatësisht 22.8 dhe 32.2 për qind. Ndërkohë, indeksi i tregtisë me pakicë u rrit me 5.5 për qind ndaj tremujorit të mëparshëm dhe u ul në nivel vjetor me 9.6 për qind. Ky fakt tregon se kërkesa e brendshme, e vlerësuar nga këta tregues nuk ka gjeneruar presione inflacioniste për periudhën në shqyrtim.

Faktorët e ofertës

Ecuria e kursit të këmbimit dhe inflacioni i importuar. Zhvillimet në kursin e këmbimit luajnë një rol të rëndësishëm në ecurinë e inflacionit. Tregu i brendshëm vazhdon të jetë i orientuar drejt importeve, të cilat për nëntëmuajorin e parë të vitit 2005 rezultojnë 3.6 herë më të larta

sesa eksportet. Deficiti tregtar nuk ka sjellë zhbancime në kursin e këmbimit, duke u financuar tërësisht nga flukset neto të kapitalit. Tendecat e kursit të këmbimit të monedhës vendase ndaj euros dhe dollarit amerikan, kanë reflektuar ecurinë e raportit të këtyre dy monedhave në tregjet ndërkombëtare. Pas një periudhe të gjatë forcimi, dinamika vjetore mbiçmuese e lekut erdhi në rënie gjatë vitit 2005. Gjatë tremujorit të katërt të këtij viti, leku është nënçmuar ndaj dollarit amerikan, por ka vazhduar të mbiçmohet ndaj euros. Duke qenë se shtetet kryesore partnere mbeten Italia dhe Greqia - eksportet dhe importet e të cilave përfaqësojnë përkatësisht 83 për qind dhe 47 për qind të vëllimit të përgjithshëm - mbiçmimi i lekut ndaj euros vazhdon të zbusë ndikimin e inflacionit të importuar.

Grafik 21. Ndryshimet vjetore të kursit nominal të këmbimit lek/euro, inflacioni i importuar (boshti majtas) dhe inflacioni në vend (boshti djathtas).



Stabiliteti i ambientit të jashtëm tregtar, si dhe mbiçmimi i kursit të këmbimit ndaj euros kanë lehtësuar presionet inflacioniste të përcjella nga ky faktor.

	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Greqi ⁶	3.9	3.7	3.9	3.9	3.5	-
Itali ⁷	2.1	2.0	2.0	2.2	2.2	-
Lek/euro	-1.8	-2.4	-1.0	-2.1	-3.7	-3.2
Lek/usd	0.0	-3.3	-1.4	1.6	5.9	9.5

Burimi: INSTAT, Sekretariati i Përgjithshëm i Shërbimit Statistikor Kombëtar të Greqisë, ISTAT-Italia.


Tabelë 16. Inflacioni vjetor i vendeve partnere dhe ndryshimi i kursit të këmbimit (në përqindje).

Ecuria e prodhimit të brendshëm bujqësor. Çmimet e produkteve ushqimore pësuan rritje gjatë gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2005, si në krahasim me vitin e kaluar ashtu dhe me gjysmën e parë të këtij viti. Ndikimi rënës i këtij faktori vlerësohet të mos veprojë me të njëjtën forcë gjatë këtij gjashtëmuajori. Të dhënat e fundit nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit e mbështesin këtë vështrim. Gjatë këtij viti parashikohet që prodhimi bujqësor të rritet me 1.3 për qind, në krahasim me 2.5 për qind që u parashikua në fillim të vitit dhe me 3.3 për qind që u realizua në vitin 2004. Krahas rritjes më të ulët të prodhimit të brendshëm bujqësor, rritja e çmimeve të produkteve ushqimore në tregjet partnere, si dhe zbutja e efektit kompensues të mbiçmimit të lekut ndaj euros, sollën si rrjedhojë një ndikim mesatar thuhet asnjëherë të grupit “Ushqime dhe pije joalkolike” (kontributi mesatar i këtij grupi në inflacionin vjetor është 0.0 pikë përqindjeje), në normën vjetore të inflacionit për gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2005.

Indeksi i çmimeve të prodhimit⁸. Pas një rritjeje të ndjeshme të çmimeve të prodhimit gjatë periudhës prill '04 – mars '05, këto çmime shënuan norma më të ulta rritjeje gjatë tremujorëve të dytë dhe të tretë të këtij viti. Në tremujorin e tretë, rritjen vjetore më të madhe e shënuan sektorët “Silvikultura, shfrytëzimi i pyjeve, shërbime plotësuese” (10%) dhe “Nxjerrja e produkteve joenergjitike” (6.8%), ndërsa “Industria përpunuese” dhe kryesisht “Industria ushqimore” regjistruan normat më të ulta, me përkatësisht 1.5 dhe 0.1 për qind. Pavarësisht rritjes së kostove të prodhimit, ato nuk u përcollën në çmimet e konsumit, kryesisht si pasojë e rritjes së konkurrencës në segmentin e tregtisë me pakicë.


Çmimet e naftës. Ndryshe nga gjashtëmuajori i parë i këtij viti, çmimet e naftës janë kthyer në

Grafik 22. Inflacionit vjetor i grupit “Ushqime dhe pije joalkolike” në Itali dhe Greqi (boshti majtas) dhe Shqipëri (boshti djathtas).



Burimi: INSTAT, Sekretariati i Përgjithshëm i Shërbimit Statistikor Kombëtar të Greqisë, ISTAT-Italia.

Grafik 23. Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të prodhimit dhe konsumit (në përqindje).



Burimi: INSTAT.

një burim presionesh inflacioniste. Ritmet e rritjes së çmimit të këtij produkti në tregjet ndërkombëtare, janë përkthyer në rritje me thuajse të njëjtën dinamikë në tregun vendas.

Tabelë 17. Ndryshimet vjetore në inflacionin e vendeve partnere dhe në kursin e këmbimit (në përqindje).

	Çmimi i naftës në vend (Lek)	Ndryshimi vjetor (%)	Çmimi i naftës jashtë (usd)	Ndryshimi vjetor (%)
Korrik	104.5	32	60.6	38
Gusht	112.4	30	68.9	64
Shtator	116.4	32	66.2	33
Tetor	116.8	23	59.8	15
Nëntor	117.1	21	57.3	17
Dhjetor	116.0	25	59.5	37

Burimi: INSTAT, Bloomberg.

Rritja e çmimit të naftës në vend, kryesisht në tremujorin e tretë të këtij viti, u shoqërua me rënien e kërkesës për të me 21 për qind në terma vjetorë dhe 18 për qind në terma tremujorë⁹. Pavarësisht nga pesha e vogël¹⁰ që ka ky produkt në shportën e mallrave të konsumit, ai shtoi mesatarisht me 0.24 pikë përqindjeje koston vjetore të jetesës në tremujorin e tretë të vitit 2005 (në krahasim me 0.17 pikë përqindjeje në tremujorin e tretë të vitit 2004). Megjithatë, rritja e çmimit të naftës nuk ka krijuar efekte të rëndësishme të raundit të dytë.

IV. POLITIKA MONETARE DHE TREGUESIT MONETARË


IV.1 POLITIKA MONETARE E BANKËS SË SHQIPËRISË

Banka e Shqipërisë ka ndjekur një politikë monetare neutrale gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2005, duke mbajtur të pandryshuar normën bazë të interesit në nivelin 5 për qind. Kjo politikë është kushtëzuar nga ecuria e qëndrueshme e çmimeve të konsumit dhe pritjet e ulta

inflacioniste për periudhën në vazhdim. Në përgjithësi, kushtet monetare vlerësohen se janë të përshtatshme për të kontrolluar rritjen e çmimeve brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë gjatë periudhës në vijim.

Në këto kushte, politika monetare dhe kuadri operacional i saj, janë fokusuar në zbutjen e disa luhatjeve të treguesve monetarë gjatë gjashtëmujorit. Si pasojë e uljes së papritur të interesit të depozitave në lekë nga disa banka si dhe rritjes së kërkesës së ekonomisë dhe qeverisë për mjete monetare gjatë tremujorit të tretë, sistemi bankar ndjeu mungesën e likuiditetit gjatë periudhës korrik-tetor. Kjo mungesë likuiditeti u përcoll më tej në rritjen e shpejtë të *yield*-it të bonove të thesarit gjatë tremujorit të tretë të vitit.

Grafik 24. Ecuria e kushteve monetare në ekonomi.




Për të përballuar këtë situatë, Banka e Shqipërisë ndryshoi kahun e operacioneve të saj kryesore, repo, duke i shndërruar ato në injektues të likuiditetit në sistem. Vëllimi mesatar i injektuar nëpërmjet instrumentit të repove të anasjellta, gjatë periudhës korrik-shtator, ishte 1.7 miliardë lekë. Po kështu, ajo përdori në mënyrë selektive kreditimin direkt të qeverisë, duke synuar shmangien e spekulimeve dhe presioneve të tepërta në rritjen e *yield*-it. Si pasojë e kësaj politike, sistemi bankar e kaloi situatën e mungesës së likuiditetit, duke vetëkorrigjuar në pjesën më të madhe normat e interesit të depozitave në lekë.

Gjithashtu, politika e Bankës së Shqipërisë në tregun valutor ka qenë në përputhje me tejkalimin e kësaj situatë. Banka e Shqipërisë ka blerë valutë gjatë pothuaj gjithë gjashtëmuajorit të dytë, duke zbutur presionet mbi kursin e këmbimit dhe duke injektuar likuiditet në treg. Nga ndërhyrjet e saj në këtë treg, vlerësohet se janë injektuar rreth 12.4 miliardë lekë likuiditet, duke ndihmuar sistemin bankar në tejkalimin e situatës.

Gjashtëmuajori i dytë i vitit 2005 nuk ka qenë i mbuluar me marrëveshje midis organizmave financiarë ndërkombëtarë dhe Shqipërisë. Megjithatë, Banka e Shqipërisë ka përmbushur treguesit indikativë të vendosur për këtë periudhë.

Grafik 25. Yield-i i bonove të theesarit 12-mujore.



	Mars '05	Qersh '05	Shtator '05	Tetor '05	Dhjetor
Rezervat Ndërkombëtare Neto (milionë dollarë)					
Objektivi	1,073	1,086.7	1,094.6	1,108.5	1114.3
Aktuale	1,107	1,098.0	1,094.6	1,119.1	1116.9
Diferenca	35	11.3	0.0	10.6	2.6
Mjetet e Brendshme Neto (miliardë lekë)					
Objektivi	61	60.0	65.7	65.7	65.7
Aktuale	53	63.6	65.7	57.8	55.8
Diferenca	-8	3.6	0.0	-7.9	-9.8
Kredia e Brendshme Neto për Qeverinë (miliardë lekë)					
Objektivi	292	297.7	302.7	304.7	306.7
Aktuale	288	294.4	301.6	299.5	296.9
Diferenca	-4	-3.2	-1.1	-5.2	-9.8

Burimi: Banka e Shqipërisë.

* Të dhëna operative.


Tabelë 18. Realizimi i objektivave sasiorë të Bankës së Shqipërisë.

IV.2 ECURIA E AGREGATËVE MONETARË

Viti 2005 është karakterizuar nga një ekspansion i lartë monetar, duke reflektuar aktivitetin e lartë ekonomik dhe rritjen e besimit në sistemin financiar të vendit. Efektin kryesor në rritjen e ofertës monetare e ka dhënë kërkesa e ekonomisë për kredi, ndërkohë që huamarrja e qeverisë nga sistemi bankar ka patur një tendencë rënëse. Ritmi i rritjes së ofertës

monetare ka shfaqur tendenca ngadalësuese në gjysmën e dytë të vitit. Ritmi i rritjes së M3 zbriti në 14.3 për qind në muajin nëntor, pasi kulmoi në nivelin 18.3 për qind në muajin qershor. Ky ishte një zhvillim i parashikuar nga Banka e Shqipërisë. Ecuria e agregatëve monetarë në këtë periudhë është ndikuar edhe nga politikat monetare stabilizuese që ka ndjekur Banka e Shqipërisë, në gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2005, për të zbutur luhatjet e normave të interesit dhe për të stabilizuar situatën e likuiditetit në sistemin bankar, gjatë kësaj periudhe. Kushtet monetare aktuale dhe tendenca e pritur e tyre, janë konsistente me ruajtjen e stabilitetit të çmimeve në periudhën afatmesme.

Grafik 26. Ecuria e normave vjetore të agregatëve monetarë.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ritmet e rritjes vjetore të agregatëve të parasë kanë shfaqur prirje të ngjashme në gjysmën e dytë të vitit. Komponenti më likuid i agregatit M3, paraja jashtë bankave, ka reaguar në të njëjtën mënyrë si oferta monetare ndaj zhvillimeve në ekonomi. Rritja vjetore e parasë jashtë bankave rezultoi rreth 8 për qind në fund të vitit, kundrejt 14.9 për qind në muajin qershor. Ritmi vjetor i rritjes së parasë jashtë bankave i rezistoi tendencës përshejtuese të rishfaqur si rezultat i kërkesës së përqëndruar të qeverisë për likuiditet, në muajin shtator dhe nivelit të ulët të normave të interesit të depozitave në lekë në këtë periudhë.

Megjithë luhatjet e parasë jashtë bankave, pesha e tyre ndaj M2 ka ardhur në rënie. Treguesi i raportit të parasë jashtë bankave ndaj M2 shënoi 33.8 për qind në muajin nëntor, duke u ulur me 0.5 pikë përqindjeje në krahasim me muajin shtator. Kthimi i këtij raporti në trendin rënës reflekton uljen e presioneve inflacioniste në anën e kërkesës në ekonomi. Rënia e parasë jashtë bankave përkthehet direkt në rritjen e depozitave në lekë.

Grafik 27. Ecuria e raportit të parasë jashtë bankave ndaj M2 dhe interesi real (djathtas).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Impakti pozitiv i këtyre zhvillimeve transmetohet më tej në përmirësimin e kapaciteteve të sistemit bankar për financimin e aktiviteteve prodhuese në ekonomi dhe mundëson plotësimin e nevojave për financim të deficitit buxhetor. Niveli i depozitave të sistemit bankar ka qenë i mjaftueshëm për mbulimin e kërkesës së ekonomisë për kredi në lekë. Pjesëmarrja në rritje e individëve në financimin e deficitit buxhetor, ka lehtësuar alokimin e burimeve financiare të sistemit bankar drejt financimit të ekonomisë¹¹.


Rritja vjetore e depozitave në lekë ka pasqyruar ritmet e rritjes së agregatit M2. Depozitat në lekë shënuan një rritje vjetore prej 10.0 për qind në muajin nëntor, kundrejt rritjes prej 14.7 për qind të muajit qershor. Rritja me 3.9 miliardë

lekë e nivelit të depozitave në lekë gjatë periudhës korrik-nëntor, është më e vogël se rritja e teprcës së kredisë në lekë në të njëjtën periudhë. Sistemi bankar e ka përballuar këtë situatë duke ulur nivelin e likuiditetit të tepërt të mbajtur prej tij. Depozitat me afat në lekë kanë pësuar rënie gjatë dymbëdhjetë muajve të fundit¹², por ajo është kompensuar nga rritja e depozitave pa afat. Rritja e peshës së depozitave pa afat në lekë ndaj depozitave totale nga 15.2 për qind në muajin qershor në 27.7 për qind në muajin nëntor, ka ndikuar në uljen e kostos së depozitave në lekë të sistemit. Kostoja marxhinale e burimeve financiare në lekë të sistemit bankar arriti në 1.2 për qind në muajin nëntor, nga 1.3 për qind në muajin qershor. Megjithatë, normat pozitive të interesave realë të depozitave në lekë kanë ruajtur kërkesën për to, duke sjellë edhe rritjen e depozitave totale në lekë dhe uljen e peshës së parasë jashtë bankave ndaj M2.

Krahas pasqyrimin të dinamikës së zhvillimeve në ekonominë e brendshme, zhvillimet në ofertën monetare kanë reflektuar edhe ecurinë e prurjeve valutore nga remitancat. Në terma absolutë, depozitat në valutë janë rritur me 16.4 miliardë lekë gjatë periudhës korrik-nëntor, kundrejt rritjes prej 12.8 miliardë lekë në të njëjtën periudhë të një viti më parë¹³. Ecuria e tyre ndikohet si nga hyrjet valutore të emigrantëve edhe nga ngushtimi i normave të interesave midis lekut dhe monedhave euro dhe usd.

Rritja e normave të interesave të euros dhe usd nga bankat qendrore përkatëse ka sjellë ngushtimin e diferencës së normave të interesave, duke influencuar mënyrën e investimit të prurjeve valutore. Megjithatë, në kushtet e një politike të ekuilibruar të Bankës së Shqipërisë ndaj ndërhyrjeve në tregjet valutore dhe të qëndrueshmërisë së kursit të këmbimit, rritja e depozitave në valutë mund të jetë reflektim i një oferte më të lartë të remitancave këtë vit, krahasuar me një vit më parë. Raporti i depozitave në valutë ndaj ofertës monetare arriti në 26.9 për qind në muajin nëntor, kundrejt nivelit 25.1 për qind të shënuar në muajin qershor të këtij viti. Gjithashtu, raporti i depozitave në valutë ndaj depozitave në lekë u rrit nga 50.4 për qind në muajin qershor, në 55.7 për qind në muajin nëntor. Rritja e depozitave në valutë në sistemin bankar influencon pozitivisht në përballimin e nevojës të ekonomisë për kreditim në valutë.

Grifik 28. Ecuria e raportit të depozitave në valutë ndaj depozitave në lekë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

	Nëntor	Ndryshimi 5-mujor		Ndryshimi vjetor	
	2005	Absolut	Përqindje	Absolut	Përqindje
Para jashtë bankave	139.7	3.8	2.8	10.8	8.4
Depozita totale	426.3	20.3	5.0	60.1	16.4
- në lekë	273.9	3.9	1.4	24.8	10.0
- në valutë	152.4	16.4	12.1	35.2	30.0
Depozita pa afat	113.5	23.0	25.4	42.7	60.3


Tabelë 19. Ecuria e treguesve monetarë në korrik-nëntor (në miliardë lekë).

- në lekë	59.9	18.9	46.0	34.8	138.7
- në valutë	53.6	4.1	8.3	7.9	17.3
Depozita me afat	305.7	-10.0	-3.1	20.2	7.1
- në lekë	209.1	-20.0	-8.7	-7.0	-3.2
- në valutë	96.5	10.0	11.6	27.2	39.3
M1	200.4	23.5	13.3	46.4	30.1
M2	409.5	3.7	0.9	39.4	10.6
M3	559.6	17.8	3.3	74.5	15.4
Baza monetare	183.9	3.4	1.9	13.5	7.9

Burimi: Banka e Shqipërisë.

IV.3 KËRKESA PËR MJETE MONETARE

Viti 2005 ka shënuar një moment pozitiv për ecurinë e treguesve monetarë. Gjatë kësaj periudhe, kreditimi i ekonomisë ka qenë burimi kryesor i përdorimit të fondeve dhe i ekspansionit monetar, duke spostuar financimin e deficitit buxhetor nga ky rol. Ndërkohë, komponenti i huaj i rritjes së ofertës monetare, mjetet valutore neto të sistemit bankar, ka ruajtur një nivel të qëndrueshëm në raport me M3.



Portofoli i kredisë së sistemit bankar për ekonominë është rritur me 18.7 miliardë lekë, gjatë periudhës korrik - nëntor 2005. Në fund të muajit nëntor, kredia për ekonominë arriti në 114.6 miliardë lekë, duke përbërë 13.7 për qind të PBB-së së vitit 2005. Brenda 5 muajve të fundit të vitit, raporti i kredisë ndaj PBB-së është rritur me 2.5 pikë përqindje¹⁴. Për periudhën korrik-nëntor 2005, kredia vazhdon të paraqesë ritme mjaft të larta të rritjes vjetore, me një mesatare prej 70 për qind.

Tabelë 20. Ecuria e disa treguesve kryesorë.

	2003	2004		2005		
		6 mujori I	6 mujori II	6 mujori I	Tetor	Nëntor
Oferta e parasë (në miliardë lekë)	448.4	458.2	507.2	541.8	567.4	566.0
Kredi e brendshme (në % ndaj M3)	71.5	69.5	68.9	69.9	69.0	69.5
Kredi për qeverinë (në % ndaj M3)	60.2	57.1	55.1	52.2	49.6	49.2
Kredi për ekonominë (në % ndaj M3)	11.3	12.4	13.8	17.7	19.4	20.2
Kredi për ekonominë (% ndaj totalit të aktiveve)	13.7	14.6	16.9	20.8	22.9	23.5
Kredi për ekonominë (në % ndaj PBB)	6.8	7.4	9.0	11.2	13.2	13.7
Raporti kredi / depozita (në %)	15.7	16.7	19.0	23.6	25.8	26.9

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Angazhimi në rritje i bankave drejt kredive me afate të gjata maturimi, ka ndikuar në rënien e peshës që zë kredia afatshkurtër ndaj totalit

të kredisë, krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit. Kjo prirje ka ndikuar pozitivisht në rritjen e tepricës së kredisë.


	2003	2004	T-1 '05	T-2 '05	T-3 '05	Tetor '05	Nëntor '05
Teprica e kredisë (në mld lekë)	50.7	69.3	79.0	95.9	106.0	110.0	114.6
Kredi afatshkurtër	46.0	34.0	34.1	33.7	31.6	31.8	32.0
Kredi afatmesme	33.3	36.0	34.5	33.1	31.2	31.3	31.2
Kredi afatgjatë	20.7	30.0	31.4	33.1	36.9	36.9	36.8
Kredi për individët	24.5	30.6	31.0	30.8	31.4	31.7	32.0
Kredi për sektorin privat	75.5	69.4	69.0	69.2	68.6	68.3	68.0
Lekë	19.6	19.5	20.1	22.9	23.7	24.5	25.2
Valutë	80.4	80.5	79.9	77.1	76.3	75.5	74.8

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 21. Tregues të tepricës së kredisë në përqindje ndaj totalit.

Rritja e kredisë në lekë ka ruajtur të njëjtat ritme me pjesën e parë të vitit, duke shënuar një rritje mujore mesatare prej 1.4 miliardë lekësh, gjatë periudhës korrik – nëntor. Në terma vjetorë, për këtë periudhë, kredia në lekë ka pasqyruar një rritje mesatare prej 142 për qind, krahasuar me normën mesatare prej 86 për qind të gjashtëmujorit të parë. Në këtë zhvillim pozitiv ka ndikuar jo vetëm angazhimi në rritje i bankave drejt kredisë për individët, por edhe kreditimi në lekë i bizneseve, i cili ruajti nivele të larta rritjeje pas impulsit pozitiv të muajit qershor.

Kreditimi i sektorit të bujqësisë ka patur rritjen më të spikatur për periudhën korrik - nëntor, duke treguar angazhim më të madh të bankave në këtë sektor. Krahas bujqësisë, me rritje të moderuar është shoqëruar dhe kredia për sektorin e ndërtimit dhe për pasuritë e paluajtshme. Rritja në këta sektorë ka balancuar rënien e peshës së kredisë për sektorët e industrisë nxjerrëse dhe atë hotelerisë dhe restorante. Ndërkohë, tregtia vazhdon të jetë sektori më i kredituar i ekonomisë duke përbërë në fund të nëntorit, rreth 19.3 për qind të totalit të kredisë.



	2003	2004	2005		Tetor '05	Nëntor '05
		6 mujori I	6 mujori II	6 mujori I		
Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	1	1.5	1.5	1.5	2.51	2.44
Industria përpunuese	17	17.1	17.1	15.6	13.8	14.58
Ndërtimi	10	9.8	9.8	11.2	12.9	12.27
Tregtia, riparimi i automobilave dhe i artikuve shtëpiakë	34	23.3	23.3	19.1	18.9	19.34
Hotele dhe restorante	6	8.3	8.3	4.7	4.4	4.35
Pasuritë e patundshme	13	9.8	9.8	13.5	14.0	13.78
Të tjera	19	30.2	30.2	34.3	33.5	33.24
Totali	100	100	100	100	100	100

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 22. Tregues të kredisë sipas sektorëve të ekonomisë (përqindje ndaj totalit).

Për periudhën korrik – nëntor të vitit 2005 janë akorduar gjithsej 50 miliardë lekë ose mesatarisht rreth 10 miliardë lekë në muaj. Krahasuar me pjesën e parë të vitit, vihet re se bankat po angazhohen më shumë drejt kredive me periudha të gjata maturimi dhe kredive në lekë. Kredia e re e muajit nëntor pasqyroi rritje të ndjeshme të peshës së kredisë në lekë ndaj totalit.

Tabelë 23. Tregues të kredisë së re (përqindje ndaj totalit).


	2004			2005		
	Nëntor	Janar-nëntor	Totali	Janar - qershor	Korrik-nëntor	Nëntor
Kredia e re (në miliardë lekë)	7.1	88.8	99.7	54.9	49.9	9.3
Kredi afatshkurtër	54.0	63.3	62.5	49.6	46.6	45.8
Kredi afatmesme	26.9	22.4	22.5	27.5	30.1	29.5
Kredi afatgjatë	19.1	14.3	14.9	22.9	23.3	24.8
Lekë	32.6	33.3	32.6	31.7	31.9	36.0
Valutë	67.4	66.7	67.4	68.3	68.1	64.0

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pozicioni valutore i sistemit bankar ka shënuar përmirësim të mëtejshëm gjatë gjashtëmuorit të dytë, megjithë rritjen e shpejtë të kredisë në valutë gjatë kësaj periudhe. Mjetet valutore neto të sistemit bankar janë rritur me 131.7 milionë usd gjatë periudhës korrik – nëntor. Rezerva valutore neto e Bankës së Shqipërisë është rritur me 67.0 milionë usd, ndërsa mjetet valutore neto të bankave të nivelit të dytë janë rritur me 64.7 milionë usd.

Blerja e valutës së huaj nga Banka e Shqipërisë në tregun valutore ka qenë arsyeja kryesore e rritjes së rezervës valutore neto të Bankës së Shqipërisë. Ulja e detyrimeve valutore të bankave të nivelit të dytë me 50.7 milionë usd, kryesisht si rezultat i uljes së depozitave pa afat të bankave të huaja, ka ndikuar në pjesën më të madhe të rritjes së mjeteve valutore neto të këtyre bankave. Rritje ka patur edhe në mjetet valutore bruto të bankave të nivelit të dytë, megjithëse akordimi i kredisë në valutë, për pjesën e dytë të vitit, ka qenë në nivele më të larta se hyrja e depozitave në valutë në sistemin bankar.

Grafik 31. Niveli i mjeteve valutore neto të sistemit bankar.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Mbajtja nën kontroll e deficitit buxhetor ka nxitur një kërkesë për para të qeverisë në nivele të moderuara. Për periudhën korrik - nëntor 2005, deficitit buxhetor rezultoi me një rritje prej 5.1 miliardë lekësh, krahasuar me 12.1 miliardë lekë që ishte rritja e tij në të njëjtën periudhë një vit më parë. Deri në muajin nëntor është shënuar një nivel financimi i brendshëm prej 15.9 miliardë lekësh, rreth 5.4 miliardë lekë më shumë se në muajin qershor. Diferenca prej 0.3 miliardë lekësh nga financimi i deficitit, ka kaluar si depozitë e qeverisë pranë Bankës së Shqipërisë. Në muajt korrik dhe shtator, qeverisë i është akorduar kredi direkte nga Banka e Shqipërisë, në shumë totale 3.5 miliardë lekë, me qëllim shmangien e luhatjeve të normave të interesit në tregun ndërbankar

dhe në atë të bonove të thesarit. Situata e përmirësuar e sistemit bankar i ka mundësuar qeverisë të kthejë të gjithë shumën.

Forma kryesore e financimit të brendshëm të kërkesës së qeverisë ka qenë shitja e obligacioneve qeveritare dy dhe tre-vjeçare. Gjatë kësaj periudhë janë emetuar përkatësisht 8.1 miliardë lekë dhe 3.9 miliardë lekë obligacione Nga ana tjetër, portofoli i bonove të thesarit është ulur me 4.3 miliardë lekë gjatë periudhës korrik - nëntor. Kjo situatë është shprehur në rënien e nivelit të portofolit të bonove të thesarit. Bankat e nivelit të dytë kanë ulur me 14.6 miliardë lekë portofolin e tyre, ndërsa institucionet me 1 miliard lekë. Rritje të portofolit të bonove të thesarit kanë shënuar individët dhe Banka e Shqipërisë, përkatësisht me 8.2 miliardë lekë dhe 3.0 miliardë lekë.


Grafik 32. Ecuria kumulative e financimit të deficitit buxhetor (në miliardë lekë).



IV.4 TREGJET FINANCIARE, NORMAT E INTERESIT DHE KURSI I KËMBIMIT

Niveli mesatar ditor i likuiditetit në sistemin bankar shënoi vlerën 2.3 miliardë lekë në gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2005, nga 7.9 miliardë lekë në gjashtëmuajorin e parë të këtij viti dhe 5.2 miliardë lekë një vit më parë. Ecuria e treguesit të likuiditetit ka qenë mjaft e luhatshme gjatë kësaj periudhe. Si pasojë e rritjes së kredisë së brendshme, e shoqëruar kjo edhe me ngadalësimin e fluksit të depozitave në lekë, sistemi bankar tregoi mungesë të përkohshme likuiditeti në tremujorin e tretë. Niveli mesatar ditor i tij zbriti në 1.1 miliardë lekë, nga 7.1 miliardë lekë një tremujor më parë. Kjo situatë u përmirësua dhe u normalizua në tremujorin e fundit të vitit, pas ndërhyrjeve të Bankës së Shqipërisë, kur niveli mesatar ditor i likuiditetit u rrit në 3.7 miliardë lekë.

Grafik 33. Huadhënia ditore në tregun ndërbankar dhe niveli i likuiditetit (në miliardë lekë).




Për administrimin e likuiditetit janë përdorur instrumentet e repos njëjavore dhe transaksionet *outright*. Në kushtet e mungesës së likuiditetit, në pjesën e parë të gjashtëmuajorit janë organizuar ankandet e repos së anasjelltë njëjavore. Krahas tyre, me qëllim injektimin e përhershëm të likuiditetit dhe rregullimin e strukturës së tij në treg, janë organizuar transaksionet për blerjen me të drejta të plota të letrave me vlerë të qeverisë. Me përmirësimin e kushteve të likuiditetit në sistemin bankar, prej muajit tetor, ka vijuar organizimi i ankandëve njëjavore të repos.

Tregu i parasë

Luhatjet e likuiditetit janë reflektuar në aktivitetin e tregut ndërbankar dhe në atë primar si dhe tek normat e interesit të aplikuara në to. Vëllimi mesatar ditor i huadhënies në tregun ndërbankar u rrit në 1.5 miliardë lekë në gjashtëmuajorin e dytë të vitit, nga 1.2 miliardë lekë në gjashtëmuajorin e parë. Në këtë periudhë vihet re rritja e huadhënies me afat shtatëditor, e cila pothuajse është dyfishuar krahasuar me gjashtëmuajorin e parë të vitit (niveli mesatar ditor është rritur në 0.9 miliardë lekë nga 0.5 miliardë lekë).

Grafik 34. Norma bazë e interesit dhe reagimi i interesave në tregun ndërbankar.



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë.

Normat mesatare të ponderuara të interesit në tregun ndërbankar, janë rritur me 1.7 pikë përqindjeje për transaksionet njëditore dhe me 0.2 pikë përqindjeje për transaksionet shtatëditore. Megjithëse një pjesë e rritjes së tyre u shkaktua nga rritja e kërkesës për likuiditete në treg në tremujorin e tretë, rritja e normave të interesit në tregun ndërbankar është ndikuar edhe nga përcaktimi i një korridori simetrik dhe më të ngushtë të interesave të lehtësive mbështetëse, nga Banka e Shqipërisë, prej ± 1.75 për qind. Vendosija e këtij korridori që nga muaji korrik 2005, solli ngushtimin e ndjeshëm të *spread*-it midis interesave të huamarrjeve shtatëditore me ato njëditore dhe luhatjen e interesave të huamarrjeve njëditore rreth normës bazë të interesit.

Mungesa e likuiditetit në tremujorin e tretë qe faktori kryesor që ndikoi në rritjen e normave të interesit në tregun primar. Oferta e bankave për bonot e thesarit, e cila deri në fund të gjashtëmuajorit të parë kishte tejkaluar shumën e shpallur për emetim nga qeveria duke ndikuar në uljen e *yield*-eve, nuk arriti të plotësonte kërkesën e qeverisë. *Yield*-i për bonot e thesarit me maturim 12-mujor arriti në 9.1 për qind në muajin shtator, nga 6.8 për qind në muajin qershor. Në këto kushte, Banka e Shqipërisë ka ofruar kredi direkte për qeverinë duke reduktuar presionet mbi normat e interesit në tregun primar.

Tabelë 24. Ecuria e normave të interesit (në pikë përqindjeje).

	Normat e interesit dhjetor 2005	Ndryshimi 6-mujori II 2005	Ndryshimi 6-mujori I 2005
Norma bazë e interesit	5.00%	0.00	-0.25
Tregu ndërbankar			
Interesi i tregut ndërbankar njëditor	4.20%	1.70	-0.90
Interesi i tregut ndërbankar 7-ditor	5.46%	0.18	-0.62
Tregu primar			
Yield-i për bono thesari 3 - mujore	5.41%	0.35	-1.03
Yield-i për bono thesari 6 - mujore	6.90%	0.50	-0.82
Yield-i për bono thesari 12- mujore	6.91%	0.12	-1.31
Tregu i obligacioneve			
Yield-i për obligacionet 2 - vjeçare	8.00%	0.40	-1.40


Burimi: Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë.

Normalizimi i situatës së likuiditetit dhe mbajtja nën kontroll e kërkesës së qeverisë, sollën uljen graduale të *yield*-eve gjatë tre muajve të fundit. Në fund të muajit dhjetor, diferenca midis *yield*-eve të bonove të thesarit dhe depozitave në lekë me maturitet njëvjeçar ra në 1.5 pikë përqindjeje, nga 3.8 pikë përqindjeje në muajin shtator.

Normat e interesit të depozitave dhe kredive

Normat e interesit të depozitave në lekë kanë shënuar rritje, sidomos në afatet e gjata të maturimit. Kjo rritje është kryesisht një korigjim i uljeve të mëdha të këtyre interesave në gjashtëmuajorin e parë të vitit. Në muajin nëntor, interesat realë të depozitave në lekë u rritën në 2.38 për qind, duke shënuar nivelin më të lartë të interesave realë që nga qershori i vitit 2005. Ky nivel është ndikuar nga rritja e interesave nominalë dhe ulja e inflacionit. Në tregun e depozitave në valutë, normat e interesit kanë vazhduar të kenë tendenca rritëse, sikurse edhe në gjashtëmuajorin e parë. Gjatë gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2005¹⁵, interesat nominalë të depozitave në usd janë rritur ndjeshëm në të gjitha afatet, ndërkohë interesat e depozitave në euro, ndonëse me luhatje, kanë pasur një tendencë rritëse të moderuar.

Grafik 35. Ecuria e normave të interesit (në përqindje).



	Normat e interesit nëntor 2005	Ndryshimi 6-mujori II 2005*	Ndryshimi 6-mujori I 2005
Norma bazë e interesit	5.00%	0.00	-0.25
Interesat e depozitave në lekë			
1 - mujore	3.49%	0.38%	-0.28%
3 - mujore	4.17%	1.09%	-1.40%
6 - mujore	4.89%	1.12%	-1.64%
12 - mujore	5.45%	1.56%	-2.10%
24 - mujore	6.54%	1.93%	-2.37%

Burimi: Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë.

* të dhënat më të fundit i përkasin muajit nëntor 2005.

Në tregun e kredive në lekë ka patur rritje të interesave gjatë gjashtëmuajorit të dytë të vitit, duke përjashtuar kreditë mbi 3 vjet¹⁶. Normat e kredisë në lekë janë ndikuar nga rritja e kostos së pranimit të depozitave në lekë dhe rritja e *yield*-it të bonove të thesarit. Njëkohësisht, ka ndikuar mjaft ndryshimi i strukturës së kredidhënies nga njëra periudhë në tjetrën si dhe akordimi në disa raste, i kredive preferenciale, me interesa më të ulët sesa interesat e tregut.


	Normat e interesit nëntor 2005	Ndryshimi 6-mujori II 2005*	Ndryshimi 6-mujori I 2005
Interesat e kredive në lekë			
Kredi deri 6 muaj	13.36%	2.74%	-0.36%
Kredi 6 muaj - 1 vit	13.29%	1.67%	-2.11%
Kredi 1-3 vjet	17.34%	0.68%	-3.76%
Kredi mbi 3 vjet	8.54%	-3.82%	-0.53%

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 25. Normat e interesit të depozitave në lekë (në pikë përqindjeje).

Tabelë 26. Normat e interesit të kredive në lekë (në pikë përqindjeje).

Grafik 36. Ecuria e interesave mesatarë të ponderuar të kredive në valutë.




Burimi: Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë
* të dhënat më të fundit i përkasin muajit nëntor 2005.

Grafik 37. Ecuria e kursit të këmbimit të NEER¹⁷.



Grafik 38. Ecuria e kursit të këmbimit të lekut dhe NEER (djathtas).



Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2005, ka pasur rritje të normave të interesit të kredive në dollarë dhe në euro, me gjithë luhatjet që e karakterizojnë këtë treg. Në rritjen e interesave të kredive në valutë ka ndikuar rritja e interesave libor dhe euribor në tregjet ndërkombëtare, rritja e kostos së pranimit të depozitave në valutë, shkalla e rrezikut të kredidhënies, ndryshimi i strukturës së saj nga një muaj në tjetrin etj.. Në muajin nëntor, interesat mesatarë të ponderuar të kredive në dollarë dhe në euro arritën përkatësisht në 8.79 për qind dhe 7.87 për qind, me një rritje prej 0.69 pikësh përqindjeje për kreditë në usd dhe 2.24 pikësh përqindjeje për kreditë në euro.

Kursi i këmbimit

Kursi i këmbimit të lekut ka qenë relativisht i qëndrueshëm gjatë gjashtëmujorit të dytë, duke treguar një ngadalësim të tendencave mbiçmuese, të vëna re gjatë pjesës së parë të vitit. Pjesa më e madhe e kësaj ecurie i detyrohet reduktimit të diferencës së normave të interesit lekë-valutë, por edhe kërkesa më e lartë për valutë të huaj me qëllim turizmin jashtë ka përforcuar këtë ecuri. Gjithashtu, ndërhyrjet valutore të Bankës së Shqipërisë, të cilat janë të përqendruara në kahun e blerjes, veprojnë në kahun e zbutjes së tendencave mbiçmuese të lekut.

Megjithë luhatjet e lekut gjatë gjashtëmujorit të dytë, leku në fund të vitit gjendet pothuajse në nivelet e qershorit. Gjatë kësaj periudhe, leku është mbiçmuar me 1.1 për qind ndaj euros dhe është nënçmuar me 0.8 për qind ndaj dollarit. Nivelet e këmbimit të lekut në fund të muajit dhjetor janë 122.6 lek/euro dhe 103.6 lek/usd. Në terma vjetorë, leku vazhdon të jetë i mbiçmuar ndaj euros, mesatarisht me 2.4 për qind për gjashtëmujorin e dytë. Kundrejt dollarit, pas një periudhe të gjatë mbiçmimi, leku gjendet i nënçmuar mesatarisht me 2.0 për qind.

V. EKONOMIA SHQIPTARE NË VITIN 2006

Treguesit makroekonomikë të vitit 2005 dëshmojnë që ekonomia shqiptare ka patur rritje ndërkohë që është ruajtur qëndrueshmëria

makroekonomike. Normat e ulëta dhe të qëndrueshme të inflacionit gjatë vitit të kaluar, ruajtja e një bilanci pozitiv të pagesave, konsolidimi i mëtejshëm financiar i shprehur në raportet e qëndrueshme të agregatëve monetarë, ndërmjetësimit më të mirë të aktivitetit ekonomik nga sistemi bankar dhe të kursit të këmbimit, vazhdojnë të sigurojnë kushte të favorshme për promovimin e aktivitetit sipërmarrës në ekonomi.

Megjithatë, zhvillimet makroekonomike gjatë vitit 2005 kanë qenë nën presionin e faktorëve të brendshëm dhe të atyre ndërkombëtarë. Kriza energjitike që kaloi ekonomia në tremujorin e fundit të vitit të kaluar, vlerësohet të ketë influencuar rritjen e ekonomisë shqiptare. Prania e këtyre efekteve gjatë këtij viti dhe madhësia e tyre, kushtëzohen nga përmirësimi i situatës energjitike. Gjithashtu, rritja e çmimit të naftës në tregjet e huaja tenton të ketë ndikime negative në rritjen ekonomike, të cilat u transmetuan edhe në ekonominë tonë. Efektet indirekte të rritjes së çmimit të karburanteve në faktorët e prodhimit mund të jenë të pranishme edhe gjatë vitit 2006. Në kushte të njëjta të faktorëve të tjerë, rritja e kostove të prodhimit do të reflektohej në zbutje të kërkesës në ekonomi dhe, rrjedhimisht, ngadalësim të ritmeve të rritjes ekonomike në të ardhmen.

Megjithatë, faktorët që mbështetën rritjen ekonomike do të vazhdojnë të ushtrojnë ndikime pozitive. Konsolidimi i vazhdueshëm i stabilitetit makroekonomik gjatë viteve të fundit, siguron një mbështetje pozitive për rritje të qëndrueshme ekonomike në vitin 2006. Ulja e deficitit fiskal do të lejojë financimin e ekonomisë dhe të aktiviteteve prodhuese nga ana e sistemit bankar. Ndërmjetësimi financiar i sistemit bankar në Shqipëri do të mundësojë mbështetjen me më tepër kredi të ekonomisë, duke përmirësuar potencialin financiar të saj. Politika monetare e Bankës së Shqipërisë do të synojë ruajtjen e kushteve monetare në ekonomi, në përputhje me objektivin e saj të inflacionit, si dhe në mbështetje të zhvillimit të tregut financiar dhe nxitjes së kreditimit të ekonomisë. Prirja e zhvillimeve makroekonomike dhe kushtet aktuale në tregjet financiare mbështetin parashikimin e rritjes ekonomike prej 5 për qind, në prani të një inflacioni që luhet rreth objektivit prej 3 për qind për vitin 2006.

	2002	2003	2004	2005*	2006*
Treguesit e ekonomisë reale	(në pikë përqindjeje)				
Rritja e PBB-së	2.9	5.7	5.9	5.5	5.0
IÇK vjetor (mesatar)	5.2	2.4	2.9	2.5	3.0
PBB nominale (miliardë lekë)	624.7	682.7	766.4	836.9	899.7
Treguesit fiskalë	(në përqindje ndaj PBB)				
Deficiti primar** (pa grante)	-3.3	-0.5	-1.8	-1.7	-1.7
Deficiti fiskal (me grante)	-6.7	-4.5	-5.1	-3.9	-4.1
Të ardhura	24.7	24.5	24.1	24.6	24.6
Shpenzime	31.4	29.0	29.2	28.4	28.7
Sektori i jashtëm					
Deficiti tregtar (milionë euro)	-1214	-1248	-1307	-1548	-1699
Deficiti i llogarisë korente (% PBB)	-10.0	-8.1	-5.5	-7.0	-8.1

Burimi: Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, INSTAT.

* Shifrat për vitet 2005 dhe 2006 janë parashikime.

** Deficiti primar përjashton shpenzimet e interesave të borxhit të qeverisë.

Tabelë 27. Treguesit kryesorë makroekonomikë.

Sektori fiskal

Treguesit fiskalë të vitit 2006 dëshmojnë një kontribut pozitiv të realizimit të buxhetit vjetor, në funksion të ruajtjes së stabilitetit makroekonomik të ekonomisë. Shpenzimet buxhetore parashikohen në 28.7 për qind të PBB-së kundrejt nivelit prej 28.4 për qind në vitin 2005. Rritja e shpenzimeve totale ndaj PBB-së favorizon rritjen e shpenzimeve kapitale në 5.5 për qind të PBB-së kundrejt nivelit prej 5.3 për qind në vitin 2005, një zhvillim që kontribuon në përmirësimin e situatës makroekonomike dhe potencialit të rritjes së të ardhurave kombëtare. Parashikimi prej 24.6 për qind ndaj PBB-së i të ardhurave buxhetore për vitin 2006 është i njëjtë me atë të vitit të mëparshëm.

Impakti pozitiv i buxhetit të vitit 2006 në zhvillimet makroekonomike, reflektohet në ruajtjen e nivelit të deficitit buxhetor në 4.1 për qind të PBB-së. Rreth 65 për qind e deficitit buxhetor do të financohet nëpërmjet huamarrjes së brendshme. Në terma të PBB-së, financimi i brendshëm i buxhetit do të jetë 2.6 për qind. Pjesëmarrja e individëve dhe e subjekteve të tjera private, parashikohet të sigurojë financim të huamarrjes së brendshme prej rreth 11 miliardë lekë, ndërsa pjesa e mbetur prej 12.8 miliardë lekë do të financohet nga sistemi bankar.

Sektori monetar

Politika monetare dhe programi monetar i vitit 2006 janë orientuar drejt përmbushjes së objektivit të Bankës së Shqipërisë, për ruajtjen e inflacionit rreth nivelit 3 për qind, me një zonë tolerance + 1 pikë përqindjeje. Kjo do të kërkojë ndjekjen e një politike monetare të kujdesshme gjatë vitit 2006. Politika monetare lehtësuese e dy viteve të fundit rezultoi e suksesshme në ruajtjen e inflacionit brenda objektivit. Gjatë nëntë muajve të fundit, norma bazë e interesit në ekonomi ka mbetur e pandryshuar në minimumin e vet historik, ndërsa norma e inflacionit ka tentuar drejt mesatares së intervalit objektiv të vitit të kaluar prej 2-4 për qind, pasi preku kufirin e poshtëm të këtij intervali në gjysmën e parë të vitit.

Parashikimet e Bankës së Shqipërisë për ecurinë e inflacionit në të ardhmen, sugjerojnë se ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit në ekonomi pritet të luhet afër nivelit 3 për qind. Megjithatë, influenza e faktorëve ekzogjenë në ekonomi dhe ndikimi i efekteve *shock* nga ana e ofertës, mbeten elemente të paparashikueshme, të cilat dalin në pah me njëfarë diference kohore në ekonomi. Kështu, efektet direkte të rritjes së çmimeve të naftës në dy vitet e fundit, nuk kanë çenuar përmbushjen e objektivit të inflacionit gjatë kësaj periudhe.

Ecuria e parashikuar e komponentëve të ofertës monetare, përbën një faktor qëndrueshmërie të flukseve monetare gjatë vitit 2006. Rritja prej 67.6 miliardë lekësh e M3 në terma vjetorë, parashikohet të përqëndrohet kryesisht në tremujorin e tretë, si rezultat i prurjeve valutore nga emigrantët. Natyra ekzogjene e rritjes së depozitave në valutë, kryesisht në baza sezonale, nuk reflekton presione inflacioniste në ekonomi. Efekti i prurjeve valutore nga remitancat, pritet të sigurojë

rritjen e depozitave në valutë me 16.5 për qind. Pesha e depozitave në valutë ndaj M3 parashikohet të rritet në 27 për qind. Përbërësit e ofertës monetare në lekë, para ja jashtë bankave dhe depozitat në lekë pritet të ruajnë kontributet e tyre në rritjen e agregatit M2. Në fund të vitit 2006, raporti i parasë jashtë bankave ndaj agregatit M2 parashikohet 35.2 për qind, ndërsa rritja vjetore e tyre parashikohet 9.2 për qind. Rritja e moderuar e parasë jashtë bankave mundëson rritje të depozitave në lekë, me rreth 29.1 miliardë lekë ose 10.6 për qind në terma vjetorë.

Burimi kryesor i rritjes së depozitave në lekë do të jetë kredia në lekë e bankave për sektorin privat. Në dallim nga tendenca historike, kredia në lekë për sektorin privat parashikohet më e lartë se kredia në lekë për qeverinë e sistemit bankar. Megjithatë, rritja prej 29.1 miliardë lekësh e depozitave në lekë, rezulton e pamjaftueshme për financimin e kredisë në lekë dhe të deficitit nga ana e sistemit bankar. Gjatë vitit 2006 parashikohet ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë nëpërmjet blerjeve me të drejta të plota të letrave me vlerë në masën 5 miliardë lekë, kryesisht gjatë pjesës së dytë të vitit. Megjithatë, në varësi të zhvillimeve monetare, Banka e Shqipërisë do të përshtatë kohën e ndërhyrjeve me të drejta të plota në funksion të ruajtjes së stabilitetit të gjendjes së likuiditetit dhe normave të interesit në tregun bankar.

Gjatë vitit 2006 rritja e tepricës së kredisë për ekonominë parashikohet rreth 53.0 miliardë lekë ose 5.9 për qind e PBB-së. Krahasuar me ecurinë e kredisë në vitin 2005, ky parashikim është rreth 7 miliardë lekë më i lartë. Kreditimi në monedhën vendase është prirur drejt rritjes gjatë viteve të fundit. Në vlerë absolute rritja e tepricës së kredisë në lekë parashikohet 19.2 miliardë lekë ose 36.2 për qind e rritjes totale të tepricës së kredisë. Në fund të vitit 2006, pesha e stokut të kredisë ndaj PBB-së parashikohet 19.0 kundrejt raportit prej 14.1 për qind në fund të vitit 2005. Në raport me rritjen e ofertës monetare prej 67.6 miliardë lekësh, rritja e tepricës së kredisë për ekonominë përbën 78 për qind të kësaj rritjeje. Kjo ecuri është në përputhje me synimin e Bankës së Shqipërisë për konsolidimin e mëtejshëm të sektorit bankar, nëpërmjet rritjes së angazhimit të burimeve financiare të sistemit bankar në financimin e sektorit privat të ekonomisë.

Zgjerimi i aktivitetit kreditues të bankave të nivelit të dytë në monedhë të huaj më tepër se rritja e depozitave në valutë, pakëson mjetet valutore neto të bankave të nivelit të dytë. Kredia në valutë për sektorin privat pritet të rritet me 33.8 miliardë lekë, kundrejt rritjes së depozitave në valutë me 24.6 miliardë lekë. Pozicioni neto i mjeteve valutore të bankave të nivelit të dytë parashikohet të pësojë rënie me rreth 11.6 miliardë lekë. Ndërsa, mjetet valutore neto të Bankës së Shqipërisë do të pësojnë rritje prej 13.4 miliardë lekësh. Në këto kushte, mjetet valutore neto të sistemit bankar parashikohet të pësojnë rritje të lehtë prej 1.8 miliardë lekësh.

SHËNIME

¹ FMN, shtator 2005, Përshkrim i Ekonomisë Botërore.

² Ndryshe nga dy sektorët e parë, të dhënat për të cilët mund të konsiderohen brenda standardeve statistikore, për sektorin e tretë shifra duhet të merret me rezerva, për faktin se ajo nuk shpreh lëvizjet që mund të ndodhin gjatë tremujorëve të vitit (vlera mbetet e pandryshuar gjatë vitit). Ajo bëhet e përdorshme vetëm në fund të vitit, kur dalin rezultatet e Anketës së Matjes së Nivelit të Jetesës mbi të cilën ajo bazohet.

³ Burimi: ISTAT; faqja e internetit <http://www.istat.it>

⁴ Burimi: Sekretariati i Përgjithshëm i Shërbimit Statistikor Kombëtar të Greqisë; faqja e internetit: <http://www.statistics.gr>

⁵ Monedhë në të cilën kryhet importimi i këtij input-i.

⁶ Burimi: Sekretariati i Përgjithshëm i Shërbimit Statistikor Kombëtar të Greqisë; <http://www.statistics.gr>

⁷ Burimi: ISTAT; <http://www.istat.it>

⁸ Burimi INSTAT, Indeksi i Çmimeve të Prodhimit.

⁹ Burimi INSTAT, Konjuktura Korrik – Shtator 2005.

¹⁰ Pësha e grupit "Transport" në shportën e mallrave të konsumit është 4.8 për qind.

¹¹ Portofoli i bonove të thesarit të individëve në periudhën korrik – nëntor është rritur me rreth 8.2 miliardë lekë ose rreth 3.5 herë më shumë se rritja e tij, në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

¹² Rënia e depozitave me afat të sistemit në vitin 2005, ka qenë rezultat i mosrinovimit automatik të kontratave të depozitave me afat në lekë nga Banka Raiffeisen, duke i klasifikuar ato si depozita pa afat.

¹³ Efekti i kursit të këmbimit në të njëjtën periudhë të dy viteve është i papërfillshëm.

¹⁴ Rishikimi në rënie i vlerës së PBB-së për vitin, ka patur ndikimin e vet pozitiv krahas rritjes së kredisë në këtë raport.

¹⁵ Të dhënat më të fundit janë deri në muajin nëntor 2005.

¹⁶ Në uljen e interesave të kredive mbi 3 vjet, ka ndikuar aplikimi i kredive preferenciale.

¹⁷ Kursi nominal efektiv i këmbimit të lekut. Rritja e kursit do të thotë forcim i vlerës së tij.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 02, datë 25.01.2006

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR EKSPOZIMIN E VLERAVE
NUMIZMATIKE NË BANKËN E SHQIPËRISË DHE ADMINISTRIMIN E
RUAJTJEN E TYRE"

Në mbështetje të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", neni 43, shkronjat (f) dhe (g) të rregullores "Për funksionimin e Departamentit të Emisionit", pika II/22, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.21, datë 28.03.2001 dhe me propozim të Departamentit të Emisionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren: "Për ekspozimin e vlerave numizmatike në Bankën e Shqipërisë dhe administrimin e ruajtjen e tyre", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Kontabilitetit dhe Pagesave për përcaktimin e procedurave kontabël.
3. Ngarkohen Departamenti i Emisionit, Departamenti i Administrimit, Departamenti i Sigurimit dhe Mbrojtjes dhe Departamenti i Kontabilitetit dhe Pagesave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Evropian dhe Komunikimit me publikimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

KRYETARI

YLLI MEMISHA

ARDIAN FULLANI

KËSHILLI MBIKËQYRËS RREGULLORE

“MBI EKSPOZIMIN E VLERAVE NUMIZMATIKE NË BANKËN E SHQIPËRISË DHE ADMINISTRIMIN E RUAJTJEN E TYRE”

PJESA E PARË DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Kjo rregullore nxirret në mbështetje të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, neni 43, shkronjat (f) dhe (g) dhe në përputhje me rregulloren “Për funksionimin e Departamentit të Emisionit”, pika II/22, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.21, datë 28.03.2001.

Neni 2

Kjo rregullore përcakton rregullat dhe procedurat që do të ndiqen për ekspozimin e vlerave numizmatike dhe administrimin e ruajtjen e tyre në Bankën e Shqipërisë.

PJESA E DYTË EKSPOZIMI I VLERAVE NUMIZMATIKE

Neni 3

Subjektet që propozojnë ekspozimin e vlerave numizmatike në ambientet e Bankës së Shqipërisë janë si më poshtë:

- Administratorët e Bankës së Shqipërisë;
- Departamenti i Emisionit; dhe
- Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Evropian dhe Komunikimit.

Neni 4

Subjektet që vendosin për kryerjen e ekspozimit të vlerave numizmatike në Bankën e Shqipërisë janë si më poshtë:

- Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, për monedhat e fondit numizmatik prej ari, platini dhe argjendi dhe që propozohet të ekspozohen për një periudhë të pacaktuar, por mbi një muaj;
- Administratorët, për vlerat e tjera të fondit numizmatik si: vlera me metale jo të çmuara, ato me kurs ligjor dhe specimene dhe që propozohet të ekspozohen për një periudhë të pacaktuar kohe. Në këtë rast, administratorët nuk mund të jenë subjekt propozues.

Neni 5

Për realizimin e procesit të ekspozimit, me urdhër të njërit prej administratorëve ngrihet grupi i punës i përbërë nga përfaqësues të departamenteve të mëposhtme të Bankës së Shqipërisë:

- Departamenti i Emisionit;
- Departamenti i Administrimit;

- Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritet Evropian dhe Komunikimit;
- Departamenti i Sigurimit dhe Mbrojtjes.

Në grupin e punës mund të përfshihen dhe specialistë jashtë Bankës së Shqipërisë.

Neni 6

Objekti i punës së këtij grupi është përgatitja e kushteve dhe marrja e masave përkatëse për konceptimin dhe krijimin e ambienteve të ekspozimit.

PJESA E TRETË

ADMINISTRIMI I VLERAVE NUMIZMATIKE TË EKSPOZUARA

Neni 7

Vlerat numizmatike, të përzgjedhura për t'u ekspozuar brenda Bankës së Shqipërisë, dorëzohen nga punonjësit e ngarkuar me vlera në zyrën e "Arkës Stok" dhe në "Arkën Numizmatike" të Sektorit të Emisionit dhe Administrimit të Parasë, dhe merren në dorëzim nga grupi përkatës i punës që ngarkohet me administrimin e vlerave të ekspozuara.

Neni 8

Grupi i punës për administrimin dhe mbarëvajtjen e vlerave të ekspozuara përbëhet nga:

- a) Në rastin e ekspozimit në ambientet e punës së administratorëve të Bankës së Shqipërisë:
 1. sekretaret përkatëse të administratorëve;
 2. një punonjës i ngarkuar me vlera në Arkën Numizmatike (nga Arka Stok); dhe
 3. një punonjës i sigurimit nga Departamenti i Sigurimit dhe Mbrojtjes.
- b) Në rastin e ekspozimit në ambiente të tjera brenda Bankës së Shqipërisë:
 1. një specialist/e i/e numizmatikës dhe muzeut numizmatik;
 2. një punonjës i sigurimit, nga Departamenti i Sigurimit dhe Mbrojtjes; dhe
 3. një specialist/e nga Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritet Evropian dhe Komunikimit.

Neni 9

Dorëzimi dhe marrja në dorëzim e vlerave të mësipërme numizmatike, dokumentohen nëpërmjet procesverbalit, në të cilin shënohen sipas rastit:

- emërtimet e vlerave numizmatike,
- kodet identifikuese,
- prerja,
- viti i emetimit,
- pesha në gram dhe titulli i tyre.

Neni 10

Procesverbali, i nënshkruar nga dorëzuesit dhe marrësit në dorëzim hartohet dhe mbahet në 6 kopje, nga të cilat, një kopje depozitohet në arkivë, një kopje depozitohet në Departamentin e Kontabilitetit dhe Pagesave, një kopje pranë Drejtorit të Departamentit të Emisionit, një kopje në Zyrën e Arkës Stok, një kopje në "Arkën Numizmatike" të Sektorit të Emisionit dhe Administrimit të Parasë, dhe një kopje tek grupi i punës përkatës.

Neni 11

Inventarizimi i vlerave të mësipërme numizmatike, bëhet në përputhje me rregulloren: "Mbi inventarizimin e vlerave materiale e monetare në Bankën e Shqipërisë", miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

PJESA E KATËRT

RUAJTJA DHE SIGURIMI I VLERAVE NUMIZMATIKE TË EKSPOZUARA

Neni 12

Vlerat numizmatike do të ekspozohen sipas rastit në pajisje ekspozimi, të tilla si: korniza, stenda apo kasa të mbyllura.

Neni 13

Pajisjet e ekspozimit duhet të kenë dy çelësa të ndryshëm mekanikë, me xham të fortë antivandalizëm dhe me sensorë sinjalizues ndaj prekjës dhe goditjes.

Neni 14

Për një administrim të sigurtë të tyre, secili çelës mbahet në dy kopje, ku kopjet e para dhe ato dublikatë, futen në pliko, plumbosen e më pas, depozitohen për ruajtje përkatësisht në Zyrën e Arkës për Veprim dhe në Zyrën e Arkës Stok.

Neni 15

Në rastet e hapjes së pajisjeve të ekspozimit, dorëzimi i plikos së çelësave dhe hapja e tyre bëhet në prani të grupit të punës për administrimin dhe mbarëvajtjen e vlerave të ekspozuara.

Neni 16

Në rast të mungesës së njërit prej pjesëtarëve të grupit të punës, për hapjen e pajisjeve të ekspozimit do të veprohet në përputhje me aktet rregullative përkatëse në fuqi të Bankës së Shqipërisë.

Neni 17

Kontrolli vizual i vlerave numizmatike, me qëllim konfirmimin e rregullsisë së tyre kryhet nga personat e ngarkuar në përputhje me nenet 18 dhe 19 të kësaj rregulloreje.

Neni 18

Në fillim dhe në fund të çdo dite pune, personat e ngarkuar për kryerjen

e kontrollit vizual të vlerave numizmatike janë si më poshtë:

- a) sekretarja e zyrës së administratorit përkatës, në rastin e ekspozimit në ambientet e punës së administratorëve të Bankës së Shqipërisë;
- b) specialisti/ja e numizmatikës, në rastin e ekspozimit në ambiente të tjera brenda Bankës së Shqipërisë.

Neni 19

Në fund të çdo jave pune, grupi i administrimit të vlerave të ekspozuara bën kontrollin vizual të vlerave numizmatike të ekspozuara, i cili dokumentohet në një libër të sekretuar nga Drejtori i Departamentit të Emisionit.

Neni 20

Në rastet e konstatimit të ndonjë parregullsie, mungese në vlera apo dëmtimi të pajisjeve të ekspozimit, dhe vetë vlerave numizmatike, pa kryer asnjë veprim tjetër, njoftohet menjëherë Departamenti i Sigurimit dhe Mbrojtjes. Përfaqësuesi i këtij departamenti dhe grupi i punës për administrimin dhe mbarëvajtjen e vlerave të ekspozuara mbajnë procesverbalin përkatës.

Neni 21

Procesverbali mbahet në 5 kopje, nga të cilat, një kopje depozitohet në arkivë, një kopje depozitohet në Departamentin e Kontabilitetit dhe Pagesave, një kopje në Departamentin e Emisionit, një kopje në Departamentin e Sigurimit dhe Mbrojtjes dhe një kopje në grupin e punës për administrimin dhe mbarëvajtjen e ekspozimit.

Për vazhdimin e procedurave përkatëse në raste të tilla, zbatohen dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 22

Për vlerat e humbura ose të dëmtuara zbatohen dispozitat ligjore dhe akte të tjera të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

Neni 23

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
ARDIAN FULLANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 03, datë 25.01.2006

PËR

“DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK TË LICENCËS PËR TË USHTRUAR
VEPRIMTARI BANKARE, BANKËS SË PROPOZUAR “BANKA E PARË E
INVESTIMEVE – SHQIPËRI SH.A.””

Në mbështetje të nenit 10 të ligjit nr.8365, datë 02.07.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe të konkluzioneve të Departamentit të Mbikëqyrjes, se plotësohen të gjitha kushtet që kërkojnë ligji “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë për këtë qëllim, si dhe bazuar në nenin 3, paragrafi 4, nënndarja “c” dhe në nenin 43, shkronja “e” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak të licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë, bankës së propozuar “Banka e Parë e Investimeve – Shqipëri sh.a.”.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Evropian dhe Komunikimit me publikimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

KRYETARI

YLLI MEMISHA

ARDIAN FULLANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 04, datë 25.01.2006.

PËR
CAKTIMIN E KONTROLLORËVE TË JASHTËM PËR AUDITIMIN E
AKTIVITETIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 68 dhe nenit 43 shkronja "g" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" me propozimin e Departamentit të Kontabilitetit dhe Pagesave dhe të Kryetarit të Entit Prokurues, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të caktojë kompaninë "Deloitte Albania sh.p.k" si kontrollore e jashtme për llogaritë, regjistrat dhe bilancin e Bankës së Shqipërisë për vitet 2005, 2006 dhe 2007.
2. Të autorizojë Administratorët e Bankës së Shqipërisë të lidhin kontratë trevjeçare me kompaninë "Deloitte Albania sh.p.k" për vlerën 12,420,000 lekë.
3. Ngarkohen Departamenti i Administrimit dhe Departamenti i Kontabilitetit dhe Pagesave me zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Evropian dhe Komunikimit me publikimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

YLLI MEMISHA

KRYETARI

ARDIAN FULLANI

